

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5411  
E martë, 27 shkurt 2018  
çmimi 0.40 €

## Ministri Bytyqi kërkon mobilizim për testin PISA 2018 ■ FAQE 6



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ ■ FAQE 4-5

## Vota e Listës Serbe për demarkacionin do të ketë pasoja

### - Lista Serbe mund ta ndryshojë qëndrimin për demarkacionin, por do të ketë pasoja



Politologu Belul Beqaj ka vlerësuar se fati i marrëveshjes për ratifikimin e demarkacionit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi ka mbetur në duar të politikës së pamëshirshme që ka obsesion pushtetin. Megjithatë, ai ka thënë se Lista Serbe mund ta

ndryshojë qëndrimin për demarkacionin por, sipas Beqajt, pasojat e ndryshimit të këtij qëndrimi do të jenë të mëdha për Kosovën. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se nëse Lista Serbe e voton demarkacionin, do ta kushtë-

zojë me votimin për asociacionin e komunave me shumicë serbe sipas Marrëveshjes së Brukselit, e jo sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese, do të kërkojë komuna të reja dhe do ta kushtëzojë transformimin e FSK-së në ushtri

NË LONDËR NIS PUNIMET SAMITI I VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR ■ FAQE 8-9



## Haradinaj: Kosova, vend me potenciale të mëdha për investime

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, përpara qindra investitorëve potencialë nga e gjithë bota, mbledhur në Londër, ka për-

mendur punën e Qeverisë së Kosovës për përmirësimin e fushës ligjore në favor të krijimit të ambientit më të mirë për investimet

e huaja. Në këtë samit të sivjetmë Qeveria e Kosovës ka prezantuar 39 projekte të cilët kapin vlerën e 600 milionë eurove

## Tre aktivistët e Vetëvendosjes mbrohen në liri ■ FAQE 7



**RENOVA**  
Magdioni  
Xhepçisht-Tetovë  
Çarëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GRUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob.: +377(0) 44 506 815  
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [sat\\_styro@yahoo.com](mailto:sat_styro@yahoo.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegjibiznesi.com  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

### AKTUALE

#### KUR LOLITA E PARTISË SEX AND CITY E BËN LISTËN KUSH ËSHTË TRADHTAR I KOMBIT ■ F.10-11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

#### HOXHAJ: STUDENTËT, PËRFITUESIT MË TË MËDHENJ NGA LIBERALIZIMI I VIZAVE ■ F.3

#### KOSOVA MERR MBËSHTETJEN E KROACISË PËR REFORMA NË SHËNDETËSI ■ F.6

### EKONOMI

#### AGRON MUSTAFËS I VAZHDOHET MANDATI NË KRYE TË TELEKOMIT ■ F.8

#### LEHTËSIRA TATIMORE PËR BIZNESET ■ F.8

### KULTURË

#### PËRURROHEN DY LIBRA KUSHTUAR ADEM DEMAÇIT ■ F.14

### SPORT

#### ZHDRELLA: LLAPI, FAVORIT PËR TITULL ■ F.20

#### KOSOVA PËSOI HUMBJE TË THELLË NGA LITUANIA ■ F.21

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka pritur në takim presidentin e Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker

## Meta kërkon heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës

Presidenti Ilir Meta i ka kërkuar presidentit të Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, heqjen sa më parë të regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës, me besimin se marrëveshja për demarkacionin ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi do të përmbyllet së shpejti me sukses

**TIRANË, 26 SHKURT** - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, priti të hënën delegacionin e lartë të Komisionit Evropian në Tiranë, kryesuar nga presidenti i Komisionit, Jean-Claude Juncker, me pjesëmarrjen e Komisionarit për Politikën e Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit, Johannes Hahn. Presidenti Meta vlerësoi si shumë të rëndësishme dhe inkurajuese këtë vizitë për Shqipërinë. Ai evidentoi faktin se të gjitha forcat politike parlamentare ndajnë të njëjtin synim madhor për integrimin e plotë të Shqipërisë në BE dhe bashkohen në dëshirën për çeljen sa më parë të negociatave të anëtarësimit. Meta shpreston se falë përpjekjeve të përbashkëta, mes Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, vendet anëtare do të binden për çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë gjatë Presidencës bullgare, gjatë këtij gjashtëmujori.

Duke theksuar rëndësinë që ka zbatimin e reformave në pesë prioritetet kyçe, presidenti Meta

vlerësoi se rezultatet janë ato që do të arisin besueshmërinë si të qytetarët shqiptarë ashtu edhe të vendet anëtare të BE-së. Duke u ndalur te zhvillimet në Ballkanin Perëndimor, presidenti Meta inkurajoi heqjen sa më parë të regjimit të vizave për qytetarët e Kosovës, me besimin se marrëveshja për demarkacionin ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi do të përmbyllet së shpejti me sukses.

Presidenti Meta ndau të njëjtën bindje mbi rëndësinë që ka forçimi i rolit stabilizues të Shqipërisë në rajon. Ai siguroi se mbetet konsekuent në rolin e tij konstruktiv dhe të dobishëm për përpunimin e marrëdhënieve dypalëshe me të gjitha vendet e rajonit, duke nënvizuar rëndësinë që ka frenimi dhe dekurajimi i politikave populiste në dëm të proceseve integruese dhe atyre të paqes në Ballkanin Perëndimor. Meta ka shprehur besimin se vendet anëtare të BE-së do t'i çelën sa më parë negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.



"Të dashur miq, kënaqësi ta takoja sot presidentin e Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker dhe komisionarin Johannes Hahn. U shprehë besimin se konsensusi kombëtar dhe zbatimi i pesë prioritetëve kyçe do t'i bindin vendet anëtare për çeljen sa më parë të negociatave të anëtarësimit me BE", u shpreh presidenti Ilir Meta, në një postim që ka bërë në "Facebook" pas takimit me presidentin Juncker.

Gjatë takimit, Junckeri është shprehur se Shqipëria duhet t'i vazhdojë reformat dhe ta ruajë rolin si vend stabilizues në rajon.

## Kocijançiq: Dialogu në frymë konstruktive, sot diskutohet për asociacionin

**Bruksel, 26 shkurt** - Prishtina dhe Beogradi kanë vazhduar të hënën dialogun në Bruksel, ku është diskutuar për implementimin e marrëveshjes së lirisë së lëvizjes, drejtësisë dhe IBM-it, ndërkohë që takimet do të vazhdojnë sot (e martë) dhe do të diskutohet për marrëveshjen për asociacionin e komunave serbe, energjinë dhe urën në Mitrovicë. Kështu ka thënë zëdhënësja e

Bashkimit Evropian, Maja Kocijançiq, pas takimit ndërmjet delegacionit të Kosovës, të udhëhequr nga Avni Arifi dhe delegacionit serb, të prirë nga Marko Gjuriq. "Takimi u zhvillua në një atmosferë të përzemërt dhe konstruktive. Të dyja palët konfirmuan gatishmërinë e tyre për t'i rifilluar diskutimet mbi tema të ndryshme që u diskutuan sot", ka thënë Kocijançiq.



## Rama: BE-ja të jetë bujare me Shqipërinë



Tiranë, 26 shkurt - Një ditë pasi priti në Tiranë presidentin e Komisionit Evropian Zhan-Klod Juncker, kryeministri shqiptar Edi Rama nuk ngurroi ta thumbojë Komisionin gjatë një vizite në Londër, në selinë e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Në një panel me kryeministrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor, Edi Rama kërkoi që Shqipërisë t'i përcaktohet një datë për fillimin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian pasi, sipas

tij, reformat e Shqipërisë janë mahnitëse. "Serbia dhe Mali i Zi janë aktualisht duke avancuar në rrugën e negociatave dhe unë mendoj se është koha që edhe Shqipëria dhe Maqedonia t'i nisnin negociatat. Në të vërtetë, nuk e kuptoj këtë hezitim në disa kryeqytete për këtë hap sepse ajo çfarë ne po kërkojmë nuk është të bëhemi anëtarë sot apo nesër, por t'i nisim negociatat që të jemi në të njëjtën rrugë me vendet e tjera. Kur vjen puna te paratë, BE-ja është koprrace dhe kur flitet për

bashkëpunim, si inkurajimi i vendeve për t'i nisur negociatat, mendoj se duhet të jetë më shumë bujare sepse në fund, mendoj se Shqipëria dhe Maqedonia kanë bërë më shumë sesa thjesht detyrat e shtëpisë. Ndaj apeli im për miqtë në Komision dhe në BE do të ishte: Nëse s'keni më para për ne, është okej, por jini më bujarë, sepse kjo s'do t'ju kushtojë asgjë, por do të jetë më e rëndësishme për të pasur një Evropë më të sigurt", deklaroi Rama.

## Basha: Opozita mbështet çeljen e negociatave

**TIRANË, 26 SHKURT** - Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, i shprehu komisionarit për zgjerim, Johannes Hahnit, mbështetjen e plotë të opozitës për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian. Gjatë takimit në Tiranë me Hahnin, kreu i opoz-

itës e nxiti komisionarin për të ndikuar për një rekomandim pozitiv nga Komisioni. "Pavarësisht prej problemeve të keqqeverisjes në vend, shqiptarët aspirojnë për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian dhe kanë përqafuar vlerat e BE-së", u shpreh Basha.

Lideri demokrat theksoi se opozita beson se hapja e negociatave do të ofrojë një mekanizëm të fortë dhe të pavarur për monitorimin e nivelit të demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe të cilësisë së qeverisjes në Shqipëri. Basha siguroi Komisionarin Hahn për

vazhdimin e angazhimit pa kompromis të opozitës për luftën kundër krimit dhe korrupsionit, të zbatimit në mënyrë kushtetuese dhe të paanshme të reformës në drejtësi, si dhe plotësimin e kritereve të tjera për hapjen e negociatave të anëtarësimit.



Shënohet nëntëvjetori i themelimit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", njëherësh edhe 55-vjetori i hapjes së Shkollës së Lartë Pedagogjike

# Hoxhaj: Studentët, përfituesit më të mëdhenj të liberalizimit të vizave

"Përmbyllja e demarkacionit këto ditë do t'i hapë rrugë liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Nuk kam dyshim se përfituesit më të mëdhenj do të jenë të rinjtë, të cilët do të kenë mundësi të dalin ta shohin botën, të studiojnë dhe të kthehen për t'i aplikuar njohuritë e tyre në Kosovë", ka thënë zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj me rastin e përvjetorit të nëntë të themelimit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti"

EPOKA  
ERE

Faton DERMAKU

Prizren, 26 shkurt - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka marrë pjesë të hënën në përvjetorin e nëntë të themelimit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", njëherësh 55-vjetorit të hapjes së Shkollës së Lartë Pedagogjike. Hoxhaj ka thënë se Universiteti i Prizrenit, rritja dhe profilizimi i tij, tregojnë qartë se vendimi i marrë në vitin 2009, për themelimin e këtij universiteti, ka qenë i drejtë dhe i qëlluar. Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka folur edhe për aktualitetin politik në Kosovë, duke thënë se me përmbylljen e temës së demarkacionit të mërkurën, do t'i hapet rruga lëvizjes së lirë përmes liberalizimit të vizave. Ai ka thënë se pjesa e shoqërisë që do të përfitojë më së shumti nga liberalizimi i vizave do të jenë të rinjtë, sidomos studentët të cilët do të kenë mundësi të dalin, të studiojnë dhe ta shohin botën, pastaj t'i aplikojnë njohuritë e tyre për zhvillimin e vendit tonë. "Përmbyllja e demarkacionit këto ditë do t'i hapë rrugë liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Nuk kam dyshim se përfituesit më të mëdhenj do të jenë të rinjtë, të cilët do të kenë mundësi të dalin ta shohin

botën, të studiojnë dhe të kthehen për t'i aplikuar njohuritë e tyre në Kosovë", ka thënë Hoxhaj në fjalën e tij drejtuar të pranishmëve.

Hoxhaj ka folur edhe për dekadën e dytë të shtetësisë së Kosovës, me ç'rast ka theksuar rëndësinë e anëtarësimit të Kosovës në OKB, duke shtuar se kjo varet shumë edhe nga angazhimi dhe puna në cilësinë e arsimit dhe universiteteve që kemi.

Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka shprehur mbështetjen e Qeverisë së Kosovës për Universitetin e Prizrenit dhe është zotuar se do të angazhohen për cilësi më të madhe që universitetet e Kosovës të jenë konkurruese me universitetet evropiane.

Ndërkaq rektori i UPZ-së, prof. dr. Ramë Vataj, ka thënë se aktualisht, si në formë edhe në përmbajtje, UPZ-ja është universiteti më i konsoliduar, me infrastrukturë moderne, staf adekuat akademik dhe administrativ dhe ofron programe studimore ekskluzive komform kërkesave të tregut regional. Ai ka shtuar se në ranglistën ndërkombëtare, UPZ-ja ka shënuar progres të jashtëzakonshëm, duke u ngritur për 10 mijë vende në krahasim me vitin 2014, ndërsa është i dyti publik në vend në këtë renditje.



## Sulmohet Konsullata e Kosovës në Francë, vidhen flamuri dhe stema e shtetit



PARIS, 26 SHKURT (ER) - Gjatë fundjavës është sulmuar Konsullata e Përgjithshme e Kosovës në Strasburg të Francës, me ç'rast është vjedhur flamuri i Republikës dhe është shkatërruar stema e shtetit. Lajmin e ka bërë me dije konsulli i përgjithshëm i Kosovës, Edon Cana. Ai ka thënë se autoritetet franceze janë marrë me këtë çështje dhe shumë shpejt sulmuesit do të zbulohen. "Gjatë fundjavës është sulmuar Konsullata e Përgjithshme në Strasburg dhe është vjedhur flamuri i Republikës si dhe është shkatërruar stema e shtetit. Simbolet e shtetit të Kosovës u pengojnë armiqve tanë! Duke i falënderuar autoritetet franceze

për mbështetjen e tyre, jemi të bindur se pas forenzikës së bërë sulmuesit shpejt do të gjenden", ka shkruar Cana. Qeveria e Republikës së Kosovës nëpërmjet një komunikate për medie ka dënuar aktin e sulmit mbi Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Strasburg, si dhe shkatërrimin e stemës së Republikës së Kosovës dhe heqjen e flamurit shtetëror nga objekti i konsullatës. Qeveria ka shprehur indignatën e thellë ndaj këtij akti dhe, duke vlerësuar angazhimin e menjëhershëm të organeve franceze, kërkon nga ato t'i zbulojnë dhe të kapin autorët si dhe t'i nxjerrin ata përpara drejtësisë. "Sulmi që ndodhi


në fundjavën e kaluar mbi Konsullatën e Përgjithshme dhe shkatërrimi i simboleve shtetërore, është akt i papranueshëm që cenon integritetin e shtetit të Kosovës. Republika e Kosovës është shtet sovran, që respekton ligjet dhe të drejtën ndërkombëtare dhe vepron me përgjegjësi në marrëdhëniet ndërkombëtare si një faktor i rëndësishëm i paqes dhe stabilitetit", është thënë në komunikatën e Qeverisë së Kosovës. Ndërkaq zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka kërkuar nga autoritetet franceze të garantojnë siguri për diplomatët e Kosovës.

Flet për "Epokën e re", Belul Beqaj

# Vota e Listës Serbe për dema

**- Lista Serbe mund ta ndryshojë qëndrimin për demarkacionin, por do të ketë pasoja**

Politologu Belul Beqaj ka vlerësuar se fati i marrëveshjes për ratifikimin e demarkacionit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi ka mbetur në duar të politikës së pamëshirshme që ka obsesion pushtetin. Megjithatë, ai ka thënë se Lista Serbe mund ta ndryshojë qëndrimin për demarkacionin por, sipas Beqajt, pasojat e ndryshimit të këtij qëndrimi do të jenë të mëdha për Kosovën. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se nëse Lista Serbe e voton demarkacionin, do ta kushtëzojë me votimin për asociacionin e komunave me shumicë serbe sipas Marrëveshjes së Brukselit, e jo sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese, do të kërkojë komuna të reja dhe do ta kushtëzojë transformimin e FSK-së në ushtri



**EPOKA E RE** | Shqipe HETEMI

**PRISHTINE, 26 SHKURT** - Politologu Belul Beqaj ka thënë të hënën se, pavarësisht prej deklaratave publike, Lista Serbe mund ta ndryshojë qëndrimin për marrëveshjen e shënimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se nëse Lista Serbe e voton demarkacionin, do ta kushtëzojë me votën për asociacionin e komunave me shumicë serbe, do të kërkojë komuna të reja, si dhe do ta kushtëzojë transformimin e FSK-së në ushtri. "Fati i kësaj marrëveshje ka mbetur në duar të politikës së pamëshirshme që e ka obsesion pushtetin. Lista Serbe është vetëm një faktor shtesë i pushtetofobisë së atyre që shkaktuan zgjedhjet vetëm për

të mbetur apo për të ardhur në pushtet. Megjithatë, Lista Serbe, pavarësisht prej deklaratave publike, mund ta ndryshojë qëndrimin. Por, pasojat e ndryshimit të qëndrimit të Listës Serbe do të jenë më të mëdha në krahasim me mosndryshimin e qëndrimit. Nëse e mbështet ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, do ta kushtëzojë votimin me asociacionin e komunave me shumicë serbe, sipas Marrëveshjes së Brukselit, e jo sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese, do të kërkojë komuna të reja, do ta kushtëzojë transformimin e FSK-së në ushtri, poste të reja, ndryshime kushtetuese", ka deklaruar Beqaj.

Ai ka theksuar se pasojat janë krijuar edhe nëse do të ratifiko-

het demarkacioni dhe, sipas Beqajt, për këtë duhet të jepet përgjegjësi morale, politike dhe juridike nga ata që demarkacionin e kanë shndërruar në instrument pushteti. Sipas Beqajt, është shumë pak e pritshme që grupi i ndarë i Vetëvendosjes ta votojë marrëveshjen sepse, sipas tij, një veprim i tillë i ndonjë individi do ta damkoste kauzën, më së shumti të ardhmen e tyre politike.

Beqaj ka thënë se pret që të zbardhen faktet dhe e vërteta për kufirin, e jo të thellohet konfuzioni.

Ai ka folur edhe për punën e Qeverisë Haradinaj, duke thënë se kjo Qeveri do të mund të mbi-jetojë edhe pas ratifikimit të demarkacionit. Sipas Beqajt, Kosova ka kaluar shumë kriza në

këtë dhjetëvjeçar, por asnjë qeveri nuk ka bërë aq shumë mashtrime dhe abuzime në këtë kohë kaq të shkurtër. "Mënyra se si është sajuar kjo Qeveri tregon se qëllimi kryesor i saj ka qenë pushteti. Realisht, Kosova ka kaluar shumë kriza në këtë dhjetëvjeçar, por asnjë qeveri nuk ka bërë aq shumë mashtrime, abuzime në kohë kaq të shkurtër. Megjithatë, kjo Qeveri do të mbi-jetojë për shkak se është e gatshme për t'i kryer edhe disa detyrime të cilat mund t'i kryejnë vetëm politikanët pa kurrfarë integriteti. Të shpresojmë se subjektet e tjera politike do të nxjerrin mësim nga aventurat e kësaj Qeverie", ka theksuar Beqaj.

**"Epoka e re":** Z. Beqaj, tashmë është arritur një marrëveshje për

miratimin e demarkacionit në mes të tri partive në pushtet (PDK-së, AAK-së, Nismës) me LDK-në, megjithatë ende nuk janë bërë votat e nevojshme (2/3) për ta ratifikuar marrëveshjen për shënimin e kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Si e shihni përfundimin e këtij procesi?

**Beqaj:** Mendoj se ky pushtet po kalon nga faza e zhgënjimit të fundit, në procesin e zhgënjimit të pafundmë.

**"Epoka e re":** Fati i kësaj marrëveshje, si duket, ka mbetur në mëshirën e deputetëve të Listës Serbe, edhe pse këta të fundit kanë deklaruar se nuk do ta votojnë. A prisni ndryshim të këtij qëndrimi?

**Beqaj:** Fati i kësaj marrëveshje ka mbetur në duar të politikës së

# Demarkacionin do të ketë pasoja

ushtri, poste të reja, ndryshime kushtetuese.

**"Epoka e re":** Si e komentoni rolin e opozitës në gjithë këtë proces? Mund të pritet që ndonjëri nga deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, të këtyre që kanë bërë një distancim nga LV-ja, do ta votojnë demarkacionin?

**Beqaj:** Është shumë pak e pritshme që grupi i ndarë i Vetëvendosjes të bëjë veprime të tilla edhe nëse ka eventualisht individë, që për favore të ndryshme, mund ta votojnë marrëveshjen. Është shumë vështirë të besohet ngaqë ata janë peng e një kauze për të cilën kanë rrezikuar jo vetëm burgun, por edhe jetën. Prandaj, një veprim i tillë, i ndonjë indivi-

di, do ta damkoste kauzën, më së shumti të ardhmen e tyre politike.

**"Epoka e re":** Nesër (e mërkurë) do të mbahet seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës në të cilën pritet të votohet çështja e demarkacionit. Cilat janë pritet të juaja? Do të kalojë demarkacioni?

**Beqaj:** Mendoj se kjo çështje ka shkaktuar pasojë me vetë faktin se është shndërruar në çështje më neuraligjike të qytetarëve rreth tre vjet. Vlerësoj se pasojat janë krijuar, pavarësisht se a do të ratifikohet. Për këtë duhet të jepet përgjegjësi, morale, politike dhe juridike nga ata që demarkacionin e kanë shndërruar në instrument pushteti. Në

njërin anë i kemi qytetarët që 'nuk japin tokë për viza'. Në anën tjetër, i kemi qytetarët që shpëtimin e presin nga liberalizimi i vizave. Pra, kufiri, qysh në ditën e dytë, pas ratifikimit eventual, mund të jetë casus belli (shkas për luftë) për ata që janë të bindur se 'Thaçi e ka tradhtuar vendin'. Mashtrimi me mbulesa të trilluara (Marrëveshja e dy presidentëve, Raporti i Komisionit të Bulliqit...) është dëshmi se është arritur konsensus i mashtruesve për ta ratifikuar Marrëveshjen e ratifikuar nga ana e Parlamentit të Malit të Zi në të cilën mund të bëhen korreksione kozmetike pa këto mbulesa mashtruese. Prandaj, unë pres që të zbardhen faktet, e vërteta për kufirin,

e jo thellimi i konfuzionit.

**"Epoka e re":** Nëse kalohet demarkacioni, a mund të mbijetojë Qeveria aktuale?

**Beqaj:** Mënyra se si është sajuar kjo Qeveri tregon se qëllimi kryesor i saj ka qenë pushteti. Realisht, Kosova ka kaluar shumë kriza në këtë dhjetëvjeçar, por asnjë qeveri nuk ka bërë aq shumë mashtrime, abuzime në kohë kaq të shkurtër. Megjithatë, kjo Qeveri do të mbijetojë për shkak se është e gatshme t'i kryejë edhe disa detyrime të cilat mund t'i kryejnë vetëm politikanët pa kurrfarë integriteti. Të shpresojmë se subjektet e tjera politike do të nxjerrin mësimë nga aventurat e kësaj Qeverie.

## Haliti: Ende nuk besoj se mund të kalojë demarkacioni

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti, ka thënë se ende nuk beson se mund të kalojë të mërkurën demarkacioni me Malin e Zi, në qoftë se nuk ka vota nga Lëvizja Vetëvendosje dhe në qoftë se edhe Lista Serbe voton kundër ose nuk vjen në seancë

**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Ndonëse Kuvendi i Kosovës ka paralajmëruar për të mërkurën seancë të jashtëzakonshme për ratifikimin e marrëveshjes për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi, ende mbetet e paqartë nëse janë siguruar 80 votat e nevojshme në favor të kalimit të kësaj çështjeje.

Partitë shqiptare brenda koalicionit qeverisës në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma Socialdemokrate dhe Aleanca Kosova e Re, kanë arritur pajtimin me partinë opozitare Lidhja Demokratike e Kosovës, për votimin në favor të ratifikimit të kësaj marrëveshjeje. Partia më e madhe opozitare, Lëvizja Vetëvendosje, është shprehur kundër kësaj marrëveshjeje, ndërkohë që Lista Serbe, partnere në koalicionin qeverisës, e cila ditë më parë ka qenë kundër ratifikimit të marrëveshjes, nuk ka ndonjë përgjigje të qartë se cili do të jetë qëndrimi i saj ditën e mërkurë.

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ka shprehur dyshimin se mund të arrihen dy të tretat e votave në Kuvend, të nevojshme për ratifikimin e marrëveshjes për demarkacion me Malin e Zi, pavarësisht se partitë



shqiptare në pushtet dhe partia opozitare - Lidhja Demokratike e Kosovës, kanë një pajtim në favor të votimit për ratifikim të marrëveshjes. "Deklarata ka, por unë

ende nuk besoj se mund të kalojë në qoftë se nuk ka vota nga Lëvizja Vetëvendosje dhe në qoftë se edhe Lista Serbe voton kundër ose nuk vjen në seancë.

Në qoftë se ndodh kjo, atëherë besoj se seanca prapë do të shtyhet. Mund të hapet debati derisa të përgatiten kushtet për t'u votuar", ka thënë Haliti.

pamëshirshme që e ka obsesion pushtetin. Lista Serbe është vetëm një faktor shtesë i pushtetofobisë së atyre që shkaktuan zgjedhjet vetëm për të mbetur apo për të ardhur në pushtet. Megjithatë, Lista Serbe, pavarësisht prej deklaratave publike, mund ta ndryshojë qëndrimin. Por, pasojat e ndryshimit të qëndrimit të Listës Serbe do të jenë më të mëdha në krahasim me mosndryshimin e qëndrimit. Nëse e mbështet ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, do ta kushtëzojë votimin me asociacionin e komunave me shumicë serbe sipas Marrëveshjes së Brukselit, e jo sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese, do të kërkojë komuna të reja, do ta kushtëzojë transformimin e FSK-së në

## Kosova merr mbështetjen e Kroacisë për reforma në shëndetësi

Zagreb, 26 shkurt (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, gjatë vizitës së tij zyrtare në Zagreb, është pritur të hënën nga ministri i Shëndetësisë së Kroacisë, Milan Kujundzic.

Ismaili dhe Kujundzic kanë diskutuar për forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve në fushën e shëndetësisë, në veçanti rreth ndihmës që ky shtet mund t'ia japë Kosovës në misionin për ndryshimin e gjendjes në sektorin shëndetësor.

Në këtë takim Ismaili ka falënderuar ministrin Kujundzic për gatishmërinë e shtetit kroat për të ndihmuar në këtë proces. "Kroacia është dëshmuar me dekada si mike e Kosovës, si dhe një ndër vendet më stabile dhe zhvillimore në rajon. Prandaj, edhe ne sot jemi këtu ta forcojmë bashkëpunimin dhe ta

kërkojmë mbështetjen e shtetit tuaj në misionin tonë për ta ndryshuar gjendjen në shëndetësinë e Kosovës", ka thënë Ismaili.

Në këtë aspekt, ministri kroat ka thënë se Kroacia do të jetë afër Kosovës edhe në këtë mision të rëndësishëm, duke ofruar ndihmën e saj në të gjitha format e nevojshme. "Nuk ka nevojë ta përmend gatishmërinë e Kroacisë për ta ofruar ndihmën e saj edhe në sektorin shëndetësor. Ne kemi shërbime shumë cilësore në Kroaci dhe në ditët dhe javët në vazhdim ekipet tona do të ulen dhe do ta konkretizojnë bashkëpunimin mes vendeve tona", është shprehur Kujundzic.

Ndihma në funksionalizimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, edukimi i vazh-



dueshëm i profesionistëve shëndetësorë, trajtimi i qytetarëve të Kosovës nëpër spitalet kroate, lehtësimet në pajisje me

viza për qëllime mjekësore dhe trajnimet e ndryshme të ekspertëve kroatë për profesionistët shëndetësorë të

Kosovës, ishin pikat në të cilat parimisht të dy ministrat u pajtuan që Kroacia do të fillojë ta ndihmojë Kosovën.

## Ministri Bytyqi kërkon mobilizim për testin PISA 2018



**EPOKA E RE**

Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 26 SHKURT - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të hënën në takimin e radhës për testin PISA 2018, i cili është mbajtur me koordinatorët e shkollave të rajonit të Prishtinës, të cilat janë përzgjedhur për të marrë pjesë në këtë test ndërkombëtar.

Ministri Bytyqi ka kërkuar mobilizimin e të gjithëve, duke filluar nga MASHT-i e deri te prindërit dhe nxënësit, në mënyrë që të arrihen rezultate sa më të mira në testin PISA. Ai ka theksuar se është e ditur që për një periudhë kaq të shkurtër nuk mund të ngrihet cilësia në arsim, por tha se duhet ta risimis vetëdijësimin

për rëndësinë e testit. "Edhe nxënësit duhet ta kuptojnë se në këtë test nuk e përfaqësojnë vetëm veten e tyre, por e përfaqësojnë vendin me rezultatet që arrijnë. Prandaj, kërkoj nga ju që në ditët që kanë mbetur, PISA të jetë temë e përditshme e diskutimit në shkollat tuaja", ka thënë ministri Bytyqi, duke ftuar të gjithë koordinatorët që të bashkëpunojnë ngushtë me Komisionin e MASHT-it të emëruar kohë më parë për organizimin e testit PISA.

Në këtë takim ishte i pranishëm edhe udhëheqësi i GIZ-it, Boris Scharlovski, organizatë kjo e cila po e mbështet MASHT-in për realizimin e testit PISA, por edhe në procese të tjera që janë të lidhura me ngritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar.

## 28 vjet nga fillimi i aksionit për Pajtimin e Gjaqeve në Ferizaj

FERIZAJ, 26 SHKURT (ER) - Janë mbushur 28 vjet kur, me nismën e Anton Çetës, kishte nisur në Kosovë aksioni atdhetar e humanitar i faljes së gjaqeve, i cili pati marrë përmasa të gjëra, duke u përhapur anembanë vendit. Në ceremoninë e organizuar në Ferizaj, në kujtim të këtij aksioni, është thënë se viti 1990 konsiderohet viti më i organizuar dhe më frytdhënës i kombit shqiptar, i cili ka hyrë në

histori si vit i bashkimit e i pajtimin të popullit shqiptar.

Ish-veprimtari i Këshillit për Pajtimin e Gjaqeve në Komunën e Ferizajt, Ismajl Hasani, ka thënë se në atë kohë njerëzit, në krye me Anton Çetën, pajtonin ata që deri dje ishin armiq, për t'u bërë miq e vëllezër. Ndërsa nënkryetari i Komunës së Ferizajt, Naim Ferati, ka thënë se gjatë ecjes kanë parë se fundshkulli i kaluar ishte plot sfida.

"Ky aksion ishte i mundimshëm, por rezultatet e tij ishin që kombi dhe populli ynë të stabilizohen, të kuptojnë çka është vëllavrasja, çka është hakmarrja e çka falja", ka thënë Ferati.

Ndërsa rektori i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, Agron Bajraktari, ka thënë se viti 1990 shënon një lëvizje të madhe në historinë e shqiptarëve.



## Përrurohet konvikti numër VIII në Qendrën e Studentëve

Prishtinë, 26 shkurt (ER) - Në Qendrën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" të hënën është përruruar konvikti numër

VIII. Në ceremoninë e inaugurimit të këtij konvikti kanë marrë pjesë ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë (MASHT), Shyqiri Bytyqi, ai i

Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Bajram Hasani dhe drejtori i Qendrës së Studentëve, Fatmir Sfishta. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka uruar studentët që

do ta kenë mundësinë të akomodohen në këtë konvikt të ri dhe modern, i cili ofron 150 dhoma për studentët e Universitetit të Prishtinës.

Gjykata e Apelit ua ka ndërprerë masën e paraburgimit aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje

# Tre aktivistët e Vetëvendosjes mbrohen në liri

Gjykata e Apelit ua ka ndërprerë të hënën masën e paraburgimit tre aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, Atdhe Arifit, Frashër Krasniqit dhe Egzon Halitit, të cilët akuzohen për sulmin me granatë në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës. Këtë aktvendim të gjykatës mbrojtja e ka vlerësuar si fillim të përmirësimit të padrejtësisë që u është bërë këtyre aktivistëve, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje ka kërkuar që aktivistët e saj të shpallen të pafajshëm nga Gjykata e Apelit

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Gjykata e Apelit ua ka ndërprerë të hënën masën e paraburgimit aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje, Atdhe Arifit, Frashër Krasniqit dhe Egzon Halitit, të cilët shkalla e parë i ka dënuar për sulmin me granatë në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës. Në njoftimin për medie, Gjykata e Apelit ka bërë me dije se ky aktvendim ka të bëjë vetëm me ndërprerjen e masës së paraburgimit, duke ua caktuar masën për mbrojtje në liri. "Kolegji penal i kësaj gjykate, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Speciale dhe ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Shkallës së Parë, të hënën, më 26.02.2018, vendosi edhe për çështjen e paraburgimit ndaj të akuzuarve dhe vlerësoi se tanimë kanë pushuar arsyet ligjore që ata të qëndrojnë në paraburgim", është thënë në njoftimin e Gjykatës së Apelit. Kjo gjykatë së shpejti pritet të vendosë edhe lidhur me

ankesën që mbrojtja e këtyre aktivistëve ka bërë në lidhje me aktgjykimin e Shkallës së Parë. "Ky aktvendim ka të bëjë vetëm me ndërprerjen e masës së paraburgimit. Gjykata brenda afatit ligjor do ta bëjë publik edhe vendimin lidhur me ankesat e palëve kundër aktgjyqimit", është thënë në komunikatën e Gjykatës së Apelit.

Pas aktvendimit të kësaj gjykate, ka reaguuar mbrojtja e të dënuarve dhe Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka kërkuar që aktivistët e saj të shpallen të pafajshëm. "Gjykata e Apelit ka ndërprerë sot masën e paraburgimit ndaj tre aktivistëve të dënuar për sulmin në Kuvend, duke e zbutur kështu një padrejtësi e cila ka filluar qysh prej datës 29 gusht 2016, kur ishin arrestuar gjashtë aktivistët të Lëvizjes. Kjo gjykatë ua ka caktuar masën për mbrojtje në liri aktivistëve Egzon Halitit, Frashër Krasniqit dhe Atdhe Arifit, të cilët Prokuroria Speciale padrejtësisht i ka akuzuar për kryerje të veprës penale e, bashkë me ta, edhe Adea Batushën. Të katër bashkë Gjykata e Shkallës së Parë i pati dënuar me 21 vjet



burgim", është thënë në komunikatën e Lëvizjes Vetëvendosje për medie, duke shtuar se kjo masë nuk është e mjaftueshme. "Megjithëse aktvendimi ka të bëjë vetëm me ndërprerjen e masës së paraburgimit, është hap i mirë që aktivistëve t'u rikthehet liria e rëmbyer padrejtësisht. Kjo masë nuk është e mjaftueshme dhe ne kërkojmë lirimin e plotë dhe shpalljen e tyre të pafajshëm. Kjo është më e pakta që mund të bëhet si korigjim i padrejtësive të shkaktuara në një proces i cili deri më

tani i ka marrë 18 muaj. Drejtësia duhet të triumfojë përmbi ndikimin dhe diktatin politik", është thënë në komunikatën e LV-së. Ndërsa avokati i deputetit Frashër Krasniqi, Tomë Gashi, ka thënë se ky vendim i Apelit është vetëm fillimi i përmirësimit të padrejtësisë ndaj aktivistëve të këtij subjekti politik. "Ndërprerja e masës së paraburgimit për aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje është vetëm fillimi i përmirësimit të padrejtësisë ndaj tyre. Gjithçka

edhe mund të përmirësohet, por kush do të japë përgjegjësi për vrasjen e Astrit Deharit?!", ka shkruar Gashi në profilin e tij në "Facebook". Ndaj aktvendimit kanë reaguuar edhe Visar Ymeri dhe Dardan Molliqaj. Gjykata Themelore në Prishtinë në nëntor të vitit të kaluar kishte shpallur fajtor Atdhe Arifin, Frashër Krasniqin, Adea Batushën dhe Egzon Halitin për sulmin në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, duke i dënuar ata me 21 vjet burgim.

## Britania vlerëson progresin që ka arritur Policia e Kosovës



**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, ka pritur të hënën në takim një delegacion të lartë të policisë së Britanisë së Madhe. Ministri Sefaj e ka njoftuar delegacion policor britanik me strukturën aktuale të Policisë së Kosovës dhe për nivelin e lartë të besueshmërisë që ka Policia e Kosovës te qytetarët e Republikës së Kosovës. Ai ka falënderuar Qeverinë e Mbretërisë së Britanisë për mbështetjen që kanë dhënë për institucionet e sigurisë së Kosovës, në veçanti ka vlerësuar bashkëpunimin e mirë që kanë policitë e të dy vendeve.

Në këtë takim u konfirmua vazhdimi i mbështetjes së Britanisë së Madhe për Kosovën në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Delegacioni britanik ka vlerësuar progresin që është arritur në Kosovë, veçanërisht sa i përket Policisë së Kosovës, e cila është profesionale dhe e përgatitur për t'u ballafaquar me situata të ndryshme. Ata premtojnë se do të vazhdojnë ta përkrahin Policinë e Kosovës dhe institucionet e sigurisë për anëtarësimin e tyre në organizatat ndërkombëtare të sigurisë.

# Bizneset informohen mbi rregulloren e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale

**EPOKA E RE****A. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe kompania Pricewaterhouse Coopers (PwC) kanë organizuar një punëtori mbi rregulloren e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim të informimit më të mirë të bizneseve që operojnë në Kosovë me implikimet që dalin nga kjo rregullore.

Drejtori i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka pohuar se rregullorja është e rëndësishme duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një kornizë të rregullative në nivel të Bashkimit Evropian, pas disa viteve prej kur është kërkuar ofrimi i një mbrojtje më të mirë për të dhënat personale për konsumatorët. Zeka ka theksuar se Oda Amerikane dhe PwC synojnë t'i informojnë kompanitë me dispozitat e reja, duke pasur parasysh ndikimet që rregullorja ka, posaçërisht në aspekt të

gjobave të reja të cilat sillen në 4 për qind të qarkullimit vjetor ose 20 milionë euro.

Drejtori i Departamentit Ligjor në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Valon Kryeziu, ka thënë se kjo rregullore sjellë risi në përpunimin e të dhënave personale. Ai ka përmendur të drejtën për fshirjen e të dhënave, transferimin e tyre, forcimin e llogaridhënies, si dhe rritjen e transparencës. Më tej, Kryeziu ka shtuar se edhe Kosova është duke punuar për harmonizimin e legjislacionit nacional me rregullat në nivel të Bashkimit Evropian, duke ftuar Odën Amerikane dhe organizatat e tjera të kontribuojnë gjatë procesit të plotësim-ndryshimit të legjislacionit.

Dzenet Garibovic, eksperte e GDPR nga PwC në Kroaci, ka theksuar rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave si primare për kompanitë në Kosovë, duke përmendur hapat që duhet të ndërmerren në të ardhmen për implementimin e kësaj rregullore. Ajo ka shpjeguar se këto rregulla vlejnjë për kompanitë



të cilat procesojnë apo ruajnë të dhëna personale të shtetasve të Bashkimit Evropian si dhe të ofrimit të shërbimeve, edhe nëse këto kompani nuk janë themeluar në vendet anëtare të

BE-së. Garibovic ka thënë se ligjet aktuale në shtetet e ndryshme duhet të jenë në përputhshmëri me GDPR, ashtu që zbatimi i tyre të bëhet sa më shpejt dhe në mënyrë të duhur.

Më tutje, pjesëmarrësit morën sqarime dhe rekomandime nga ekspertët e PwC-së për zbatimin e kësaj rregullore si dhe detajet dhe kërkesat e tjera të GDPR-së.

## Agron Mustafës i vazhdohet mandati në krye të Telekomit

**PRISHTINË, 26 SHKURT (ER)** - Ministria për Zhvillim Ekonomik (MZHE), e cila, sipas ligjit, ka për detyrë mbikëqyrjen e Telekomit të Kosovës, ka konfirmuar se Telekomit i Kosovës edhe për tre muaj do të vazhdojë të menaxhohet nga drejtori aktual Agron Mustafa.

Pesë ministrat e Qeverisë së Kosovës: Valdrin Lluka, Albena Reshitaj, Bedri Hamza, Bajram Hasani e Pal Lekaj, të cilët përbëjnë këshillin ndërministror, kanë votuar në mënyrë unanime për vazhdimin e mandatit të drejtorit aktual të Telekomit, Agron Mustafa, të cilit i ka përfunduar mandati i rregullt javën e kaluar.

Drejtori aktual i Telekomit të Kosovës, Agron Mustafa, do të jetë në krye të kësaj kompanie

edhe për tre muaj të tjerë, deri në muajin qershor.

Vazhdimi i mandatit edhe për tre muaj dhe votimi unanime nga ana e pesë ministrave të Qeverisë së Kosovës erdhi pas një situatë të paprecedentë ligjore, në mungesë të bordit të kompanisë dhe konkursit për përzgjedhjen e një drejtori të ri, situatë e cila në asnjë ndërmarrje publike në Kosovë nuk ka ndodhur më parë. Ministria për Zhvillim Ekonomik, e cila ka për detyrë ligjore mbikëqyrjen e Telekomit të Kosovës, ka saktësuar se votimi unanime nga ana e ministrave ka për qëllim mbajtjen e stabilitetit të kompanisë për një periudhë të shkurtër kohore, deri në muajin qershor, periudhë kjo gjatë së cilës shpresohet të përzgjidhen bordi dhe drejtori i ri.



## Lehtësira tatimore për bizneset



**PRISHTINË, 26 SHKURT (ER)** - Gjatë vitit 2017 nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) janë shqyrtuar 241 aplikacione, prej tyre 226 aplikacione për lirim të TVSh-së në importimin e lëndës së parë, si dhe 15 aplikacione për pajisje të teknologjisë

informative. Ndërsa numri i përgjithshëm i këtyre kërkesave të aprovuara është 234 dhe 7 tjera të refuzuara. Sipas një komunikate të ATK-së, nga fillimi i vitit 2018 e deri më tani numri i kërkesave të shqyrtuara për lirim të TVSh-së në impor-

timin e lëndës së parë dhe pajisjeve të teknologjisë informative është 356, prej tyre 346 kërkesa janë për lirim të lëndës së parë dhe 10 për pajisjet e teknologjisë informative. Gjithsej 272 kërkesa janë aprovuar dhe 79 janë në proces të trajtimit, ndërsa 5 të

tjera janë refuzuar. "Këto lehtësira tatimore janë bërë me qëllim të stimulimit të prodhuesve vendorë, si dhe rritjes së qarkullimit të prodhimeve vendore brenda dhe jashtë vendit", është thënë në komunikatën e ATK-së.



Në Londër nis punimet samiti i vendeve të Ballkanit Perëndimor

# Haradinaj: Kosova, vend me potenciale të mëdha për investime



Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, në fjalën e tij përpara qindra investitorëve potencialë nga e gjithë bota në Londër, ka përmendur punën e Qeverisë së Kosovës për përmirësimin e fushës ligjore në favor të krijimit të ambientit më të mirë për investimet e huaja. Në këtë samit të sivjetmë, Qeveria e Kosovës ka prezantuar 39 projekte konkrete, që kapin vlerën e 600 milionë eurove

tyre janë folës të disa gjuhëve të huaja", ka thënë Haradinaj.

Takimi i së hënës i gjashtë kryeministrave të Ballkanit Perëndimor u hap nga presidenti i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Suma Chakrabarti, i cili u zotua për vazhdimin e bashkëpunimit të mirë mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe EBRD-së, duke shprehur përkrahjen e tij në mbështetjen e projekteve regjionale të këtyre vendeve dhe në projektet për infrastrukturën rrugore, hekurudhore dhe të energjisë.

Fillimin e punimeve të samitit të Londrës me një fjalë hyrëse e ka përshëndetur, përveç presidentit Chakrabarti, edhe kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borisov, i cili kryeson presidencën e EU-së dhe Matt Hancock, përfaqësues i Qeverisë Britanike, i cili tha se Ballkani Perëndimor ka potenciale reale për investime, por duhet një bashkëpunim. "Britania e Madhe është e përkushtuar për stabilitet dhe prosperitet. Po punojmë ngushtë

me secilin vend për përmirësimin e klimës ligjore dhe ekonomike", ka deklaruar Hancock.

Kryeministri Haradinaj ka falënderuar presidentin e EBRD-së dhe ka shprehur përkushtimin e Qeverisë së vendit për zhvillimin e projekteve regjionale dhe bashkëpunimin në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke përmendur projektet, si: ndërtimin e linjës së re hekurudhore që lidh Kosovën me Shqipërinë, një linjë tjetër që lidh vendin me Malin e Zi, përfundimin e autostradës Prishtinë - Shkup dhe interesimin që Kosova të ketë qasje në gazsjellësin Trans-Adriatik. "Përpjekjet e Kosovës për ta finalizuar infrastrukturën e saj bazike, autostradën, hekurudhën, furnizimin me ujë, atë me rrymë, janë parakushte për investitorë, në mënyrë që ata të jenë nga rajoni ynë ose më gjerë", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se për të bashkëpunuar me vende të tjera, është e nevojshme një klimë e

mirë investive.

Kosova në Samitin e Londrës është përfaqësuar nga kryeministri Ramush Haradinaj, i shoqëruar në delegacion nga zëvendëskryeministri Dalibor Jevtiq, ministri i Zhvillimit Ekonomik Valdrin Lluka, ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti dhe koordinatori për Ballkanin Perëndimor, Gazmend Abrashi.

Në samitin e sivjetmë, qeveria e vendit ka prezantuar 39 projekte konkrete, që kapin vlerën e 600 milionë eurove. Projektet vijnë nga sektori publik dhe ai privat dhe janë të dedikuara në infrastrukturën rrugore, trajtimin e ujërave të zeza, ujë të pijshëm, projekte nga prodhimi i energjisë alternative dhe projekte të prodhimit. Ka më shumë se pesë muaj që Qeveria e Kosovës është përgatitur për Samitin e Londrës, duke zhvilluar takime të shumta në nivel lokal në komunat e Kosovës dhe me përfaqësuesit e bizneseve nga vendi.

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

**LONDËR 26 SHKURT** - Në Londër ka nisur takimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në Samitin e organizuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh). Kosova në këtë samit po përfaqësohet nga kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, i cili ka prezantuar dhjetëra projekte konkrete, me qëllim financimin për realizimin e tyre.

Në fjalën e tij përpara qindra investitorëve potencialë nga e gjithë bota, kryeministri Haradinaj ka përmendur punën e Qeverisë së Kosovës për për-

mirësimin e fushës ligjore në favor të krijimit të ambientit më të mirë për investimet e huaja, për bizneset e vogla dhe korporatat, për heqjen e taksave në disa sektorë për ta stimuluar rritjen ekonomike, krijimin e një klime më të mirë investive në fushën e bujqësisë, në fushën e teknologjisë informative dhe prodhimit të energjisë alternative. "Kosova ka popullatën më të re në Evropë. 65 për qind e saj është nën moshën 35-vjeçare, fakt ky që e bën tregun e punës tejet atraktiv. Të rinjtë tanë kanë përvetësuar në masë të madhe teknologjinë informative, duke u bërë një nga top vendet në botë për përdorimin e saj. Shumë prej

# KUR LOLITA E PARTISË SEX AND CITY E BËN LISTËN KUSH ËSHTË TRADHTAR I KOMBIT



**Behxhet Sh. SHALA -  
BAJGORA**

Lehtësi e padurueshme e të quajturit tradhtar: Ratifikimi i marrëveshjes për shënim të kufirit me Malin e Zi ka hyrë në fund të rrugës pas një ngërçi thuajse trevjeçar. Një proces i filluar mbrapshtë, prapa shpinës të qytetarëve të Kosovës dhe me tre kalorës të Apokalipsit; Hashim Thaçin, ish-kryeministër e tash i njohur me nofken president i Kosovës, Skender Hyseni, ish-ministër për Punë të Brendshme që e nënshkroi marrëveshjen pa u pyetur fare dhe pa të drejtë kundërshtimi dhe një mashtruese ordinere dhe djerrakohëse që së fundi u dekorua nga presidenti post-historik, shef i saj. Se për çka u dekorua nuk e kam të qartë sepse ajo e kishte për qëllim mbushjen e llogarisë dhe shëtitjet e përjavshme në kanaxheqet e Brukselit. Një vend që e ka për qëllim të njihet si shtet duhet t'i ketë kufijtë e përcaktuar ndërkombëtarisht dhe as Kosova në këtë drejtim nuk bën përjashtim. Mendoj se askush nuk do ta kundërshtonte demarkimin e kufirit me Malin e Zi po të ishte një proces transparent e jo një mashtrim i qytetarëve që ia bënë ata që kishin për detyrim të jenë transparentë.

Po kështu, edhe ndërkombëtarët që na teshin të pasmet me kërkesë për transparencë, në rastin e Kosovës, jo që u rreshtuan prapa kalorësve të Apokalipsit por, për dallim të shteteve të tjera të rajonit e që, sikur Serbia, Bosnja dhe Mali i Zi, e kishin një të kaluar kriminale, nuk kërkuar fare transparencë, por e futën ratifikimin e demarkacionit si kusht për lib-

eralizim të vizave e që lirisht mund të konsiderohet si demokraci patologjike apo, me fjalë më të buta, dhunim të demokracisë. Mali i Zi shpejt e shpejt e votoi ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit dhe në këtë mënyrë e mbylli çështjen me Kosovën ndonëse, në praktikë ndërkombëtare, një marrëveshje e tillë nuk mund të konsiderohet si e përfunduar nëse nuk votohet nga të dyja palët nënshkruese. Pastaj, Mali i Zi u bë anëtar i paktit NATO, kurse ne, më të lodhëtit e Ballkanit dhe të Evropës, vazhduam t'i bëjmë karshillëk Malit të Zi dhe NATO-s. Fjalët i kemi të mëdha, punët më të vogla se pleshti. Duke i dëgjuar partitë që e kundërshtonin këtë marrëveshje e që thirreshin në sakrificë në mbrojtje të kufirit, jo te vendi ku duhet të mbrohej, por në kafeteritë e kryeqytetit dhe sex-angazhimet partiake, si flijim për sakrificë sublime deri në makiaton apo esspreson e fundit, atëherë edhe kështu siç po përfundon, mirë po përfundon! Pa fije turpi dhe përgjegjësie, manipuluan me qytetarë për interesa personale, partiake, materiale dhe ekzistenciale, politike dhe fizike. Komisioni qeveritar i Murat Mehës doli me një raport që na qetë më mirë se para fillimit të procesit të bisedimeve për demarkacion. U sulmuva nga opozita dhe një pjesë të deputetëve të pozitës që përbehej nga PDK-ja dhe LDK-ja. Isa Mustafa nuk pati guxim ta dërgonte marrëveshjen për ratifikim në Kuvend, sepse judejtë brenda LDK-së do ta rrëzonin këtë marrëveshje. PDK-ja ka pasur dhe ka deputetë që kanë dëshirë t'i ekspozojnë çoçet që nuk i kanë, por edhe këtë e bëjnë me lejen e liderit apo të shefit. Kur vjen me e rreh pyka - pykën e votojnë, duke kënduar këngë patriotike. Mungesa e guximit për ta dërguar marrëveshjen për votim në Kuvend i kushtoi Isës me shkarkim. Madje, Isa bëri gabim sepse, edhe në çastet kur e pa se "iku për lesh", nuk dha dorëheqje, por e shkarkuan Danushi me Slobën.

LDK-ja u hatërua shumë dhe kundër të gjitha parimeve demokratike i doli në mbrojtje Isës, jo se e dashuronin shumë kryetarin, por se mbronin interesat e veta. Pas shkarkimit të Isës, pas zgjedhjeve të parakohshme, u krijua një situatë tjetër dhe disa koalicione të tjera të cilat më parë jo se nuk pajtoheshin për asgjë, por ishin në raporte krejtësisht armiqësore.

Koalicionin PDK-AAK dhe Nisma për Kosovën, në rrethana gjysmënormale, ndërkombëtarët nuk do ta linin bashkë as për syneti e lëre më ta marrin mandatin për qeverisje. Proceset nëpër të cilat po kalonte dhe pritej të kalojë Kosova ishin përcaktuese për formulën e koalicionit qeverisës, kurse LV-ja, pavarësisht prej përpjekjeve për zbutje në raport me ndërkombëtarët, duke u bërë parti thujta rugoviane, e kollarisur sikur adoleshentët e Versaçes, nuk arriti t'i bindë se duhet të qeverisin, përveç rrymave të Nikolla Maduros dhe Raul Kastros, në Bundestagun gjerman. Në politikën ballkanase, para dijes e cila nuk është përcaktuese aspak për marrje dhe mbajtje të pushtetit, koçëmëdhentë dhe përdoruesit e shkopit të bejsbollit apo stupcit, bëhen partnerë të ndërkombëtarëve. Proceset nëpër të cilat po kalon dhe do të kalojë Kosova nuk durojnë oportunistë dhe pllazmakeksa politikë, por pranojnë vetëm mujsharë që, "për interes të shtetit dhe të pushtetit, të shkokërdhojnë me dru".

Këta të LDK-së këtë nuk mund ta bëjnë, jo pse nuk duan, por se janë frikacakë, sidomos në marrje të vendimeve. Ata duan që të tjerët të sakrifikohen, kurse këta ta marrin pushtetin në saje të sakrificave të tjerëve, duke luajtur gjithmonë rolin e viktimës. Të viktimizuar gjithmonë, por nuk e di për çka. Merreni me mend po ta kishte hequr Isa Mustafa flamurin kombëtar nga Sheshi i hajdutëve të Sex and City, çka do të bëhej?! Do ta rripnin për së gjalli, pa anestezi

fare! Natyrisht se Isa nuk do ta bënte këtë kurrë, në mungesë të guximit, pa dyshim. Ramushi e hoqi, askush nuk kundërshtoi përpos një të plagosuri në protestat paqësore kur u ekzekutuan Arbeni dhe Moni, Nerjovës të cilin e kap dajaku edhe nëse intervenon policia në Senegal. Këta të bashkimit kombëtar nuk u dukën asgjëkund sepse po merren me bashkimin kombëtar si e drejtë që duhet të realizohet gjithsesi, por jo pa pëlqimin e Bashkimit Evropian.

Me ndërrimin e kohëve, po ndryshojnë edhe qëndrimet. Pasi e realizuan bashkimin kombëtar, tash po merren me mbrojtjen e 8200 ha që ua paskan shitur Murat Meha (Merlin Monro) dhe "lideri karizmatik" i Malit të Zi, me anën e Maestro Bulliqit, çun i Agim Veliut, imperatorit të Podujevës dhe "renegat" i Isa Mustafës, i ndihmuar nga Josip Broz Tito.

Në seancën e fundit ishte një përplasje e madhe midis Ramushit dhe krejt LDK-së dhe në këtë përplasje Ramushi kishte plotësisht të drejtë. Nuk kërkoj asgjë që nuk i takonte. LDK-ja, si trashëgimtare e partisë së masave popullore, e dalë nga Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës të Jugosllavisë, në mënyrë tipike e shantazhoi votën për demarkacion me përjashtimin e komisionit qeveritar që udhëhiqej nga Bulliqi, kurse kërkoi që raportin i qeverisë së Isa Mustafës të jetë përcaktues. Dihet mirë se raportin Meha e prodhoi marrëveshjen e Brukselit, kurse raportin Bulliqi marrëveshjen Thaçi - Vujanoviq. Ramushi nuk e kundërshtoi propozimin të votohet si pako ku do të futeshin të gjitha në një thes, mirëpo LDK-ja e përdori shantazhin si mjet për qëllime politike. I vetmi nga LDK-ja që u mbajti mësim të gjithëve se si duhet të fitohet përmes një diskutimi jashtëzakonisht intelektual, të matur, të pakundërshtueshëm dhe përmbytjesor, ishte diskutimi i Kujtim Shalës. Bravo, bravo, bravo! Nga ana ime. Tash u arrit një marrëveshje pasi lëshoi

rrugë ai nga i cili nuk pritej se do ta bënte këtë, Ramush Haradinaj. Dhe mirë bëri, ndonëse e fyen rëndë, në rastin konkret, pa arsye. Realisht, në këtë luftë me fjalë, Ramushi doli fitues absolut sepse e imponoi raportin Bulliqi si material orientues pas të cilit duhet të shkojnë të tjerët.

LDK-ja bëri shumë gabim që nuk pranoi të futen të gjitha materialet në një thes por, me një veprim të pamencur dhe shantazhues, e faktorizoi raportin e Bulliqit, ndonëse është diametralisht i kundërt me raportin Meha. Nuk është aspak me rëndësi a quhet raportin Bulliqi orientues apo me një emërtim tjetër sa është me rëndësi që po trajtohet si raport. Në rrethana normale, në asnjë kontekst nuk do të kishte mundësi të votohen dy raporte që e përjashtojnë njëri-tjetrin. Te ne del të jetë e mundshme. Në rastin në fjalë nuk u gjuhëzua Ramushi, por LDK-ja, ndërsa PDK-ja në cilësinë e spektatores po e vëzhgon situatën. Isa nga Gjermania, në shërim e sipër, për çka i dëshiroj shumë sukses, ndikonte dhe pengonte në vendimmarrje për ta dërguar vendin në zgjedhje, duke vlerësuar se ka gjasa të mëdha për fitore. Tash e kemi një situatë ku, për të kaluar votimi, duhen votat e partisë së Serbisë në Kosovë, Listës Serbe dhe votat e dy krahëve të ish-LV-së, krahu Sex and City apo krahu të hajnave (jo të gjithë) dhe krahu i avangardës së ilegales së LPK - OMLK-së, të mishëruar në Hydajetin me shokë, plus krahu i rinisë r(e)volucionare, si pjesë premtuese e së ardhmes. Nëse arrijnë ta marrin Naitin nga PDK-ja dhe Zafën e Nismës Socialdemokrate, kush do t'i ndalë pastaj?! Çfarë kombinimi i hatashëm, krahu sakrifikes i avangardës së ish-ilegales plus intelektualizmi brilant i Naitit dhe Zafës!!! Pa, pa, pa... Mirë dhe mbarë do të ishte që njëherë dhe vendosmërisht t'i thyhen turinjët Serbisë në Kosovë duke e defaktorizuar përfundimisht këtë monstrum të Serbisë bren-

da Kosovës, Listën Serbe dhe për këtë duhen votat e LV-së apo mbetjes së saj e quajtur Sex and City. Me këtë patriotizmin e ashtëzuar folklorik, vështrirë se do të votojë ndryshe pos deklarimit. Pra, Vuçiqi përsëri do ta përdorë Listën Serbe si xhoker për ndërhyrje në punët e Kosovës e që nuk i takon kurrsesi.

Nëse nuk fiton asnjë votë nga Lista Serbe ose nga avangarda e ilegales lpkiste të LV-së ose krahut të Ali Babës me 40 hajdutë nga Sex and City, do të fitojnë Bulliqi dhe Josip Broz Tito. Besoj se të mërkurën demarkacioni do të votohet, nëse mbahet seanca.

E dinë të gjithë, sigurisht edhe Albini, se edhe po të ishte në pushtet vetë Albini me 40 hajdutët e Sex and City, nuk do të kishte tjetër mundësi, përveç ta votojë këtë marrëveshje. Duket se, deshe apo nuk deshe, pa e votuar nuk do të shpëtojmë! Në këtë situatë, ndonëse mendojnë se do të fitonin, askujt nuk i konvenojnë zgjedhjet e parakohshme, përveç Alternativës për Gjakovën që i ka tre anëtarë e dy deputetë dhe AKR-së që e ka vetëm një deputet (Lamin) dhe dy deputetë të pavarur nga dashuria për AKR-në (Labi dhe Korabi). Pse e them kështu?!

1. LV-ja është e përcarë dhe e ndarë në avangardën e ilegalityt të lpkistive dhe Sex and City. Këta të fundit mund të forcohen edhe me disa deputetë sepse kanë akumuluar kapital të vjedhur në shuma të mëdha përmes lejeve të ndërtimit dhe ndërrimit të destinimit të tokës, nga ajo bujqësore në atë për ndërtim. Ky subjekt që manipuloi aq keq dhe aq frikshëm me ndjenjat idealiste të patriotëve të vërtetë, mbeti krejtësisht lakuriq, si mbreti në përrallat e Andersonit. Krahu i ndarë mund të afrohet me LDK-në sepse e kaluara e paraardhësve biologjikë dhe politik i bashkon. LV-ja i ka djegur të gjitha kartat e mëdha, kurse tash ka mbetur të luajë me të imëta prandaj ndahet keq në zgjedhje eventuale.

2. PDK-ja është çarë si bostani i Rahovecit. Krahu intelektual, që kurrë nuk ka qenë PDK, ka pozicione të forta, ndonëse disa janë hajdutë ordinerë, mashtrues dhe rrenacakë. Edhe krahu i luftës u përça bukur shumë. Sigurisht, jo për shkaqe politike dhe patriotike. Për PDK-në po luajnë një kohë të gjatë të njëjtë lojtarë e që më nuk janë të motivuar, përveçse të marrin ndonjë post, duke mruzuar. Katastrofale për PDK-në është rritja e madhe e numrit të biondinave, politike dhe jopolitike.

3. LDK-ja është çuar peshë sikur dikur PDK-ja, duke kërkuar zgjedhje të parakohshme, përmes Dullës së radikalizuar. E dini si u nda PDK-ja në zgjedhjet e fundit?! Edhe më keq do të ndahej LDK-ja. LDK-ja ka mbetur pa lider dhe është një luftë e

pashpallur për dizginat e Isës. Elefantët e LDK-së nuk dorëzohen, kurse të "rinjtë" kanë ambicie më shumë se që kanë investuar.

4. AAK-ja do ta ruante këtë pozicion sikur edhe Nisma dhe besoj se do të rriteshin pak.

5. AKR-ja do të triumfojë bindshëm në Marec dhe Hajvali. Do t'i kthehej origjinës. Vetëm të qenit patericë e dikujt do të mbetej në skenën politike.

Vetëm shkathhtësia e të bërit koalicion me partnerë të duhur do ta ndryshonte skenën politike të Kosovës. Kështu, do të mbetej ashtu siç është, ligatinë politike dhe ligatinë morale. Po, njëherë nuk ka zgjedhje, as të parakohshme e lëre më të jashtëzakonshme.

Rreth flamurit të pëshqjelluar: Pasi Ramushi e vendosi flamurin e Ahtisarit te rrethi i Zogut me 40 hajdutë, u rrit entuziazmi për këtë flamur për të cilin askujt zemra verr nuk i bënë. Dolën patriotët kosovarë në mbrojtje të këtij flamuri dhe në çastet e orgazmës të shpërthimit të parakohshëm, nga fotelet dhe zyrat e veta propozuan që i njëjti flamur të vendoset në Graçanicë dhe Mitrovicën e Rakiqit. Edhe unë u trimërova fort. U thashë djemve, armët në brez, mbani pordhët se po shkojmë në Graçanicë dhe Mitrovicë. Graçanicën e kam shkelur edhe më parë kur shkoja të blejë vezë dhe karotë.

Djemtë më pyetën se kush do të na prijnë dhe kur u thashë se do të jenë Mentori, Lili dhe Hasha, vetëm sa nuk u pshurrën së qeshuri. Kot u përpoqa t'i bind se Mentori, si udhëheqës i Shtëpisë së vetme publike të legalizuar në Kosovë, ku prostitucioni gazetaresk dhe lëvryja janë shndërruar në art së të vepruarit, e ka përnjëmend dhe se ka përkrahje politike. Për herë të parë nuk më dëgjuan ani pse ia lëshova zërin deri në kupë të qiellit himnit shaljan: "Shtatë shaljanë po shkojnë në Shtoj...". Nuk po dhez më vëlla, si më parë! Duket se shumë dallojnë Shtoj, Graçanica dhe Mitrovica. Oj Kosovë dhe bukuroshe, me Behgjetin qoshe më qoshe: Begja po bëhet njeriu më i rëndësishëm në Kosovë. E ndali Burundin mos ta tërheqë njohjen e pavarësisë së Kosovës. E dha kontributin në luftë kundër ISIS-it. Me një deputet, i mori katër ministri dhe një zëvendëskryeministër. U bë kardashi më i ngushtë i Hashimit. Të gjithë po e thërrasin bacë pasi baca Adem më nuk iu duhet disa mashtruesve të veshur me pushtet. Po mos t'ia ndante Albini Agim Tartufit (lloji më fisnik dhe më i çmueshëm i kërpuhave) meritat si zëvendësues i Hasan Prishtinës, Gjet Pacolli do ta fshinte nga historia Hasan Prishtinën, ndonëse nuk e ka shkrepuar një plumb të vetëm për shqiptarët, Kosovën dhe Shqipërinë.

Behgjet Pacolli e shpëtoi

demarkacionin, koalicionin, Kosovën, Gjakovën etj. Gjeti e hapi grazhdin në Hajvali për politikanët e për t'ua mbushur cullën e sa për kokë, gjendja mbetet e pandryshuar. Gjeti u bë flamuri dhe stema e Kosovës. Gjeti u bë himni i Kosovës të cilin do ta pranoja si të tillë po të mos fliste. Po Gjeti është bërë himn me tekst, që nuk lexohet, nuk kuptohet dhe nuk duhet të dëgjohet. Gjeti, si autoritet që e kanë bërë të tjerët, vetëm sa nuk e rrahu Palin. Arsyeja ishte pse Pali ia ka ndryshuar trasenë e autostradës për Gjilan e të cilën Gjeti kishte planifikuar ta kalojë përmes oborrit të Gjetit. Pali ishte trim kur i gjuante policët e Kosovës me shishe uji, ve të paziera dhe gaz lotsjellës. Kundër Gjetit nuk pati guxim ta bënte asnjë pordhë të vetme. Sepse, po ta bënte, ndryshe do të sillej Gjeti. Kjo është Kosova, deri-këtu kanë shkuar punët, janë shpalosur të gjithë gypat e kanalizimit dhe po kundërmojnë së tepërmi. Jo nga barkëqijtjet, por nga ndryshku moral.

Nga injoranca, nga tërrpia, nga pafytyrësia, nga mizëria dhe nga jonjerëzia! Vetëm më mbetet ta citoj Gergjin e Madh të Fishtës: "Ndihmo Zot si ke ndihmue...".

Për tradhtarët: Hashim Thaçi u shpall tradhtar, pa një vendim të Gjykatës kompetente. Sipas avangardës së ilegales së lpkistëve, Hashimit nuk po i shkruhet mirë. Esat Pashë Toptani po del të jetë patriot, përballë Hashimit, nëse i besohet LV-së. Mirë ka bërë LV-ja që po vepron sipas ligjeve në fuqi dhe nuk e ka detyruar Avni Zogianin të bëhet si Avni Rrustemi. Përsëri LV-ja po i riciklon temat e mëdha, në pamundësi të merret me tema tokësore. Një Lolitë e Sex and City shkoi edhe më larg; e quajti Ramushin tradhtar. Pa u turpëruar fare dhe pa u skuqur fare. Tash, Ramushin mund ta quani si të doni, por ta quani tradhtar duhet të pajisen me një dëshmi të mjekut, ku qartazi shkruan se keni probleme të pariparueshme me trurin, nëse nuk e keni të hequr fare. Ramushi tradhtar, me gjithë atë luftë që e ka bërë dhe me të gjitha ato sakrificat, mua nuk ma kapë truri. Cilësimi tradhtar te ne përdoret me një lehtësi të padurueshme dhe të palejueshme. Dhe të paturpshme. Lolitë, kur Ramushi dhe Luani e përgjakën kufirin shqiptaro-shqiptar, ku ishte ti dhe ku ishin të tjerët?! Nuk e besoj se ka sot shqiptar në Kosovë që do ta jepte qoftë edhe një milimetër tokë të Kosovës. Madje, të tillë në kohë të tashme nuk mund të gjeni as te bashkëpunëtorët e dikurshëm të Titos dhe të Millosheviqit. Jo se nuk do ta bënin, por se çmimi për këtë është shumë i lartë. Të shkon koka! Lëreni tradhtinë, merruni me sex. Tradhtia të shkatërron, seksi të relakson. Besoj se pajtoheni me mua?! Së paku, këtë herë, Lolitë!



## Malisheva nis përgatitjet për shënimin e 'Epopesë së UÇK-së'

**MALISHEVA, 26 SHKURT** - Nën drejtimin e kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, të hënë është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit të Drejtorëve, ku drejtorët e drejtorive komunale kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për javën e ardhshme. Në këtë mbledhje kryetari Begaj ka kërkuar angazhim nga drejtorët, për realizimin e planifikimeve për vitin 2018, si dhe ka kërkuar të mos ketë vonesa për realizimin e projekteve të planifikuar. Në këtë mbledhje është

raportuar edhe për përgatitjet për shënimin e Epopesë së UÇK-së, si dhe përgatitjet për shënimin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, ku janë planifikuar të mbahen një varg aktivitetesh, në kuadër të shënimit të këtyre datave, nga ana e drejtorive për kulturë dhe asaj të arsimit. Po në këtë mbledhje është raportuar edhe për vazhdimin e aplikimeve për subvencione nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, si dhe fushatat e vaksinimit të kafshëve, si masa parandaluese ndaj sëmundjeve tek kafshët.



## 100 kamera të sigurisë do të vendosen në qytetin e Gjilanit

**GJILAN, 26 SHKURT** - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka bërë me dije se 100 kamera të sigurisë do të vendosen në këtë komunë, investim ky nga ICITAP-i dhe Ambasada Amerikane në vlerë prej 88 mijë dollarësh. "E falënderoj ICITAP-in dhe Ambasadën Amerikane për mbështetjen për realizimin e këtij projekti shumë të

rëndësishëm për Gjilanin. Kamerat do të vendosen në qytet, nëpër institucionet publike, në shkolla dhe në tri hyrje-daljet e qytetit dhe me këtë do të krijohet një siguri dukshëm më e madhe për qytetarët", ka thënë Haziri. Ai ka theksuar se projekti do të fillojë brenda pak ditësh, ndërsa do të përfundojë brenda këtij viti.

"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (14)

# GAZETA DHE REVISTA TË PËRZGJEDHURA SHKRUAJNË PËR ADEM DEMAÇIN



Selatin NOVOSELLA

4. Revista "Alternativa" (Nr. 1/2, janar/shkurt 1990). Në intervistën për revistën "Alternativa", Adem Demaçi, tha: "Askush, pra as armata dhe policia jugosllave, nuk mund t'u premtojnë siguri shqiptarëve të Kosovës në qoftë se ata do të ndjehen si robër, të shtypur dhe pa të drejta. Ndërkaq, kurrfarë zgjidhje nuk mund të ketë pa shqiptarët ose kundër tyre".

5. Revista "Alternativa" (Nr. 5, maj 1990). Adem Demaçi: "Kam dëshirë të më quani vëlla" Pyetjen e parë që i bëri gazetari i revistës "Alternativa", Adem Demaçi, i cili para pak kohësh u lirua nga vuajtja 28-vjeçare e burgut, se si ta thërrasin, ai u përgjigj: "Zotëri - jo! Dikush më quan zotëri, por s'kam ç't'i bëjë. Le të më quajnë si të donë. As Shok! Sepse, për disa, shoku mund të mos jetë i dashur. Quamëni vëlla, sepse vëllai është i dashur dhe i pranueshëm për të gjithë".

6. Gazeta "Nedelja" (13 maj 1990). Adem Demaçi: "Për formimin e Shqipërisë së dytë do të duhej të kundërshtonte Shqipëria"

Në intervistën për gazetën e Sarajevës "Nedelja", Adem Demaçi, deklaroi: "Në qoftë se ndokush do të duhej të kundërshtonte formimin e Shqipërisë së dytë, siç thoni ju për Republikën e Kosovës, atëherë ajo do të duhej të jetë Shqipëria. Megjithatë, këtë Shqipëria nuk e kundërshton, ndërsa shqiptarët e Kosovës nuk mund ta pranojnë statusin e pakicës, meqë ata janë populli i tretë në Jugosllavi".

7. Revista "Fjala" (1 qershor 1990). Adem Demaçi: "Inteligjencia jonë ka një vlerë shumë të madhe"

Në intervistën për revistën "Fjala" shkrimtari i njohur, Adem Demaçi, tha: "Intelektualët tanë janë superior edhe sa i përket gatishmërisë për sakrificë, për flijim për të vërtetën, për të mirën e njerëzimit, kështu që në sytë e mi inteligjencia jonë ka një vlerë shumë të madhe, prandaj edhe jam krenar që i përkas kësaj inteligjencie. Edhe e dua fort".

8. Radio "Zëri i Amerikës" (18 nëntor 1990). Adem Demaçi: "Forcat demokratike në Bosnje, Mal të Zi dhe Serbi do të çelin

perspektiva edhe për shqiptarët e Kosovës"

Për emisionin e Radios "Zëri i Amerikës" veprimtari i shquar, Adem Demaçi, deklaroi: "Në qoftë se ndodhë që të fitojnë forcat demokratike në Bosnje dhe eventualisht në Mal të Zi ose edhe në Serbi, atëherë do të çelët perspektiva edhe për popullin shqiptar në Kosovë".

9. "Radio Shqiptari" (24 shkurt 1991). Adem Demaçi: "Shqipëria na mbajti gjallë shpirtin tonë" Simboli i rezistencës kombëtare, Baca Adem Demaçi, në intervistën e dhënë për "Radio Shqiptarin", në Detroit, tha: "Shqipëria është mbështetja jonë strategjike, Shqipëria është shtylla jonë, Shqipëria ishte ajo që na e mbajti gjallë shpirtin tonë që të mos harrojmë çka jemi".

10. "Radio Beogradi II" (29 mars 1991). Adem Demaçi: "Pse shqiptarët të mos iu ngritin përmendore Hasan Prishtinës dhe Bajram Currit?"

Në intervistën e gjatë të dhënë për "Radio Beogradin II", në Beograd, Adem Demaçi tha: "Kur serbët u ngritin përmendore mbretërve dhe princërve të tyre, pse të mos u ngritim përmendore edhe shqiptarët Hasan Prishtinës dhe Bajram Currit? Kur serbët këndojnë këngë patriotike "igraju se delije usred zemle Serbije", atëherë pse edhe shqiptarët të mos e bëjnë të njëjtën gjë e të këndojnë "O prite, prite Azem Galica".

11. Gazeta "Bashkimi" (Maj 1991). Adem Demaçi: "Pa organizimin e faktorit të brendshëm nuk mund të zgjidhen problemet në Jugosllavi"

Në pyetjen e gazetës "Bashkimi" e cila botohet në Prishtinë, Adem Demaçi, tha: "Unë nuk mendoj se vetëm faktori i jashtëm me të gjitha mundësitë e tij të shumta (si ato ekonomike, financiare, shkencore, teknike, teknologjike, diplomatike e propagandistike) do të jetë në gjendje që ta zgjidhë çështjen e Jugosllavisë në mënyrë paqësore. Pa organizimin e fuqishëm demokratik adekuat të forcave antihegemoniste edhe brenda Jugosllavisë, rreziku nga gjakderdhja nuk besoj se mund të evitohet".

12. Gazeta "Zëri" (28 mars 1992). Adem Demaçi: "Është meritë e Partisë Socialiste që nuk ndodhi gjakderdhja në Shqipëri"

Adem Demaçi, duke komentuar zgjedhjet e para shumëpartiake në Shqipëri, në gazetën "Zëri" të Prishtinës, deklaroi: "Kjo është një fitore e gjithë popullit shqiptar. Më në fund, kjo është një fitore edhe e ish-Partisë së

Punës, përkatësisht Partisë Socialiste të Shqipërisë. Ky ishte një projekt shumë delikat dhe shumë i rëndë. Pra, ishte projekt i dorëzimit të pushtetit. Dhe është një sukses i tyre. Kjo s'duhet t'u mohohet. Historia do të dëshmojë këtë gjë".

13. Gazeta "Rilindja" (25 gusht 1992). Adem Demaçi: "Jam munduar ta jap një pasqyrë për të vërtetën në Kosovë"

Në intervistën e gjatë të Adem Demaçit për gazetën "Rilindja" në Zvicër, jepë këtë informatë: "Jam angazhuar që në takimet e mia me personalitete të ndryshme të jap mendimin tim dhe një pasqyrë të përgjithshme për të vërtetën në Kosovë. Jam takuar me një numër të madh personalitetesh në vendet evropiane siç janë: Belgjika, Danimarka, Holanda, Gjermania, Suedia por edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku kam pasur biseda me senatorë, kongresmenë, sekretarë shtetesh etj., me të cilët kam biseduar gjatë për gjendjen e shqiptarëve në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi, e prej të cilëve kam kërkuar që të angazhohen shumë më tepër për zgjidhjen paqësore të çështjes shqiptare".

14. Gazeta "Telegraf" (10 janar 1996). Adem Demaçi: "Pala serbe më tepër po aktron se është e gatshme të bisedojë me shqiptarët"

Adem Demaçi, në një intervistë ekskluzive për gazetën beogradase "Telegraf" të 10 janarit 1996, thotë: "Pala serbe më tepër po aktron se është e gatshme për bisedime me shqiptarët e Kosovës. Në të vërtetë, ajo përgatitet për diçka tjetër, në formë të diktatit, e cila do t'i vente shqiptarët para aktit të kryer. Regjimi serb, nëse donë të bëjë bisedime, së pari duhet të jap shenja të qarta se ajo është e gatshme që të heq gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë, t'i tërheq forcat ushtarake-policore dhe t'ua kthejë shqiptarëve ato që me dhunë ua ka marrë".

15. Emisioni shqip i BBC-së (20 mars 1996). Adem Demaçi: "Kjo Serbi është e papranueshme edhe për popujt sllav, slovenët, kroatët, boshnjakët, maqedonasit dhe malaziasit"

Adem Demaçi, në një intervistë për emisionin shqip të BBC-së, thotë: "Unë kam ardhur në Evropë që t'i paralajmëroj qarqet evropiane, personalitetet dhe institucionet e ndryshme evropiane se kjo zgjidhje të cilën ata e mendojnë se do të mund të fle për Kosovën, se mund të realizohet, se do të mund të zbatohet, duke pasur për bazë njëfarë autonomie për Kosovën, domethënë duke i lënë shqip-

tarët nën mëshirën e kësaj Serbie, e cila është e papranueshme edhe për popujt sllave, siç janë slovenët, kroatët, boshnjakët, maqedonasit dhe malaziasit, kjo nuk do të jetë zgjidhje fatlumë".

16. Gazeta "Frankfurter Rundschau" (8 shtator 1998). Adem Demaçi: "Hill dhe Holbruk nuk e kuptojnë mirë natyrën e regjimit serb!"

Adem Demaçi në intervistën për gazetën gjermane "Frankfurter Rundschau", përveç tjerash, deklaroi: "Unë frikësohem se Hill dhe Holbruk nuk e kuptojnë mirë natyrën e regjimit serb. Ne i njohim këta edhe nga Slovenia, nga Kroacia dhe nga Bosnja. Nëse nuk intervenojnë Evropa dhe Amerika në Serbi nuk di se për ç'arsye ekzistojnë OKB-ja, NATO-ja dhe OSBE-ja, nëse ato nuk janë të afta për të reaguar?"

17. Gazeta "Kosova sot" (18 shkurt 2008). Adem Demaçi: "Adem Jasharit do t'i thosha - Jugosllavi më s'ka!"

Në pyetjen e gazetës prishtinase "Kosova Sot" që i bëhet Adem

Demaçit "Çka do t'i thoshe Adem Jasharit", Demaçi përgjigjet: "Adem Jasharit do t'i thosha - o vëlla, ti u flijove me familje dhe me shumë shokë të tjerë dhe me mijëra luftëtarë, heronj, dëshmorë. Mirëpo, ne arritëm atë që kërkuam me shekuj, Jugosllavi më s'ka! Serbinë e kemi sjellë deri në atë shkallë sa të kthehet në ato trojet e vete, të cilat i kishin arritur serbët, pra dihet ajo Serbia e vitit 1912".

18. Gazeta "Epoka e re" (21 dhjetor 2010). Adem Demaçi: "Lufta e UÇK-së ishte luftë e pastër"

Adem Demaçi, në intervistën për gazetën prishtinase "Epoka e re", deklaroi: "Është e rëndësishme që lufta e shqiptarëve të Kosovës ishte e pastër dhe ky është argument kryesor që na mbron në raport me çfarëdo akuze. Prandaj, krahas hetimeve për akuzat ndaj UÇK-së, duhet të kërkohet edhe fillimi i hetimeve për krimet monstruoze të Serbisë, jo vetëm në Kosovë, por në të gjitha luftërat që ky shtet i ka shkaktuar në Ballkan".

(Vijon)



## Putini urdhëron pauzë humanitare në Goutan Lindore

**MOSKË, 26 SHKURT** - Autoritetet ruse kanë paralajmëruar një pauzë humanitare për kryengritësit sirianë në Goutan Lindore. Kjo pauzë humanitare do të fillojë prej sot (e martë). Ministri i Mbrojtjes së Rusisë,

Sergei Shoigu, ka thënë se presidenti Vladimir Putin ka urdhëruar ndërprerjen e armiqësive prej orës 9.00 deri në orën 2.00, njoftojnë agjencitë ruse të lajmeve.

Shoigu, po ashtu, ka thënë se

do të hapet një korridor në Ghouta për t'i lejuar civilët të largohen. Deri më tani nuk ka pasur reagime nga Qeveria siriane, grupet rebelle apo nga Kombet e Bashkuara. Ky njoftim ka ardhur pasi Këshilli i

Sigurimit i OKB-së më 24 shkurt ka miratuar një rezolutë që kërkonte një "armëpushim" prej 1 muaji për t'i lejuar dërgesat e ndihmës dhe evakuimet mjekësore në zonat e konfliktit në Siri.



## Ministrat e Jashtëm të BE-së, të shqetësuar për situatën në Siri

Shefja e politikës së jashtme e BE-së, Federica Mogherini, u bëri thirrje tre garantuesve të procesit të paqes në Siri, Rusisë, Iranit dhe Turqisë, për ta garantuar vendosjen e zonave të shtensionimit

**BRUKSEL, 26 SHKURT** - Ministrat e Jashtëm të Bashkimit Evropian shprehën të hënën shqetësim rreth situatës në Siri derisa po mbledheshin për një takim të rregullt në Bruksel. Komentet vijnë pas bombardimeve të reja që u ndërmorën të dielën në rajonin e Ghoutas Lindore të mbajtur nga kryengritësit. Sulmet ajrore janë shtuar, pavarësisht një rezolute të Kombeve të Bashkuara gjatë fundjavës që bën thirrje për një armëpushim 30-ditorë.

Shefja e politikës së jashtme e BE-së, Federica Mogherini, u bëri thirrje tre garantuesve të procesit të paqes në Siri, Rusisë, Iranit dhe Turqisë, për ta garantuar vendosjen e zonave të shtensionimit.

"Në përgjithësi unë jam jashtëzakonisht e shqetësuar, edhe ministrat, për shtimin e operacioneve ushtarake në të gjithë Sirinë, nga aktorë të ndryshëm. Natyrisht, para së gjithash, nga regjimi dhe mbështetësit e tij, dhe ka një përgjegjësi të veçantë sidomos nga tre garantuesit e procesit të paqes", tha Mogherini.

Bombardimet e reja në Ghoutan Lindore vijnë pas një vote të Këshillit të Sigurimit në favor të një armëpushimi prej 30 ditësh. Menjëherë pas miratimit të rezolutës, ambasadorja e ShBA-së, Nikki Haley, veçoi Rusinë, duke kritikuar ashpër homologët e saj rusë për



vonesën e votimit. "Çdo minutë që ky Këshill priste për Rusinë, vuajtjet njerëzore shtoheshin. Dhe me gjithë këtë pritje, zor se rezolutës iu shtua ndonjë gjë, përveç disa fjalëve dhe presjeve.

Njerëzit në Siri nuk duhet të vdesin duke pritur që Rusia t'i dërgojë udhëzimet nga Moska. Ose për t'i diskutuar ato me siri-anët", tha ajo. Presidenti sirian Bashar al-

Assad, i mbështetur nga Rusia dhe Irani, është rikthyer gradualisht në zonat ku kundërshtarët u ngritën kundër sundimit të tij në vitin 2011. Ghouta Lindore është bastioni i fundit i madh kryengritës pranë Damaskut.

Ndërkaq ministri i Jashtëm rus Sergei Lavrov hodhi poshtë të hënën akuzat se forcat besnike ndaj udhëheqësit sirian duhen fajësuar për një sulm me klor në Ghoutan Lindore. Ai tha se këto pretendime janë një provokim që synon sabotimin e një armëpushimi në këtë zonë.

Bombardimi i Ghoutas Lindore gjatë javës së kaluar ka qenë një nga më të rëndët e luftës shtatëvjeçare në Siri. Sipas statistikave të hartuara nga Observatori Sirian për të Drejtat e Njeriut, me qendër në Britani, një monitor i luftës në Mbretërinë e Bashkuar, në vetëm shtatë ditë janë vrarë të paktën 522 njerëz.

## Trysni ndaj ligjvënësve amerikanë për të marrë masa ndaj dhunës me armë



**UASHINGTON, 26 SHKURT** - Ligjvënësit amerikanë që kthehen në Uashington këtë javë do të përballen me trysni në rritje për të marrë masa për dhunën nga armët në Amerikë, pas një vrasjeje tjetër masive që mori jetën e 17 vetave në një shkollë të mesme në Florida.

Ditët e fundit nxënësit amerikanë janë mobilizuar politikisht në një nivel që nuk është parë që nga Lufta e Vietnamit, duke kërkuar që Uashingtoni të veprojë. Presidenti Trump po i kërkon Kongresit ta forcojë kontrollin për historinë e blerësve të armëve, ta rrisin moshën kur

lejohet blerja e armëve gjysmë automatike dhe t'i ndalojë pajisjet që i bëjnë armët të godasin më me shpejtësi. Ai po nxit shkollat t'i lejojnë mësuesit të mbajnë armë, për të qëlluar sulmues të mundshëm. "Pse i mbrojmë aeroportet dhe bankat, ndërtesat qeveritare, por jo shkollat? Ka ardhur koha ta bëjmë shumë më të vështirë që shkollat të jenë në shënjestër të sulmuesve. Nuk i duam në shkollat tona", thonë ata.

Armatosja e mësuesve mbështetet me forcë nga mbrojtësit e të drejtës për armëmbajtje, por ligje të reja për masa të

forta për armëmbajtje bien ndesh me të. Shoqata Kombëtare e Armëve thotë se tragjedia në Florida mund të ishte parandaluar nëse autoritetet federale do të kishin vepruar pas disa paralajmërimeve për autorin e sulmit. "Ky i çmendur nuk duhej të ishte lejuar kurrë të blinte armë, kurrë... Anëtarët e shoqatës sonë janë prindër. Ne shohim fëmijët tanë në çdo fëmijë, nuk duam të shohim më kurrë diçka të tillë", kanë thënë nga kjo qendër.

Armatosja e mësuesve është hedhur poshtë nga guvernatorët e dy partive politike dhe nga vetë disa mësues.

## Turqia dërgon forca speciale në Afrin

**ANKARA, 26 SHKURT** - Turqia ka dërguar forca speciale në rajonin sirian Afrin, në pritje për "luftime të reja" në zonat urbane, si pjesë e operacionit të saj ndaj milicive kurde, ka thënë të hënën Ankaraja. Më 20 janar Turqia nisi ofensivën në enklavën perëndimore të Afrinit, për t'i mbështetur rebelët sirianë ndaj milicive kurde të njo-

hura si Njësitet për Mbrojtjen e Popullit (YPG), të cilat mbështeten nga Shtetet e Bashkuara. "Dërgimi i forcave speciale është pjesë e përgatitjeve për luftimet e reja që po afrohen", ka thënë zëvendëskryeministri turk, Bekir Bozdag.

Agjencia shtetërore e lajmeve në Turqi, "Anadolu", ka thënë se një

numër i paspecifikuar i forcave speciale kanë arritur në rajonin e Afrinit të dielën në mbrëmje. Turqia e konsideron YPG-në si organizatë terroriste dhe e sheh si zgjatim të Partisë Punëtoare të Kurdistanit (PPK) në Siri.

PPK-ja konsiderohet si grup terrorist nga Ankaraja, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.



Vështrim

# Jusuf Gërvalla, një zë i veçantë në letërsinë moderne shqipe

Sadik BICAJ

Jusuf Gërvalla njihet si poet dhe prozator, publicist dhe përkthyes, muzikant dhe atdhetar i shquar, që veprimi deri në vdekje, pa u trembur, për liri dhe pavarësi të Kosovës. U lind në fshatin Dubovik të Pejës në vitin 1945 dhe vdiq në Shtutgart të Gjermanisë, përkatesisht u vra nga shërbimi sekret jugosllav, në vitin 1982.

Shkollën fillore e kreu në vendlindje, të mesmen në Prishtinë, ndërsa studimet i filloi në Lubjanë dhe i kreu në Prishtinë. Një kohë punoi si përkthyes në gazetën "Flaka e vëllezërimit" në Shkup, prej nga kaloi gazetar në të përditshmen "Rilindja" në Prishtinë. Në fillim të vitit 1980 emigroi në Gjermani, ku një vit më vonë (1982) vritet para banesës së vet nga dora e fshehtë e regjimit serb. Që nga vitet e shtatëdhjetë nisi të shkruajë dhe të botojë nëpër gazeta dhe revista në gjuhën shqipe që dilnin në Prishtinë dhe në Shkup. Shkroi kryesisht poezi e prozë për të rritur.

Veprat letrare të shkrimtarit Jusuf Gërvalla janë: "Fluturojnë e bien" (Prishtinë, 1975), "Kanjushë e verdhë" (Prishtinë, 1978), "Shenja të shejta" (Shkup, 1980), "Rrotull" (Tiranë, 1983), "Procesi" (Prishtinë, 1984). (Hasan Hasani "Leksikoni i shkrimtarëve", Prishtinë, 2000, f. 156 e 157).

Vepra e tij letrare fatkeqësisht nuk është shumë e njohur në trojet shqiptare, edhe me gjithë shkrimet dhe studimet e shumta që janë bërë për këtë autor.

Në këtë drejtim, një punë të mirë e ka bërë akademik Sabri Hamiti në librin

"Vepra letrare e Jusuf Gërvallës" (Ora, Prishtinë, 1992), ndërsa më vonë, pikërisht në vitin 2010, tekstin e Sabri Hamitit e vejnë në ballë edhe Shtëpia Botuese "Faik Konica" në Prishtinë, duke vlerësuar si tekstin më gjithëpërfshirës dhe më analitik të veprës letrare të



Jusuf Gërvallës.

Poezia e Jusuf Gërvallës është tipike origjinale dhe shumë domethënëse për kohën. Ajo është një poezi etnike, shpeshherë e ndërtuar në kolonë, me varg të lirë dhe mjaft e pasur edhe me figuracione të shumta stilistike, duke përfshirë këtu edhe një vargëzim (metrikë) të veçantë. Gërvalla poezinë e tij e ndërton mbi fjalët kyçe, si: shtëpi, nënë, fshat, vendlindje, rrugë, njeri, ujë, mjegull, buzëqeshje, dashuri, etj., ndërsa mbi bazën e tyre janë ndërtuar poezitë: "Shtëpia në kornizë", "Shtëpia në rrugë", "Shtëpia rrezë malit",

"Fshati rrezë malit", "rruga që shpie në livadh", "Skëna nga jeta e fshatit", "Bekimi i nënës", "Ujë i gjelbër", "Mjegulla", "Buzëqeshja", "Njeriu i zi", etj, si këto.

Jusuf Gërvalla para lexuesve doli me tri vëllime të poezive "Fluturojnë e bien" (1975), "Kanjushë e verdhë" dhe "Shenjat e shenjta" (1979), si dhe një numër të madh poezish të pabotuara. (Ramiz Dërmaku, Wikipedia.org) Sipas akademik Sabri Hamiti thuhet se "Çiltëria në shprehja, melankolia si gjendje zotëruese shpirtërore e mërgimi si gjendje e subjektivitetit poetik janë veçantë e para të gjithë poezisë së Jusuf Gërvallës.. "Jusuf Gërvalla vepra,

SHB Faik Konica", Prishtinë, 2010, f. 8)

Në poezinë e Jusuf Gërvallës shtëpia dhe nëna bëhen dy protagonistët e kësaj jete, jetës së rëndë të katundit, të një jete të braktisur, por të paharruar, edhe nga ata që shtëpitë e tyre u mbuluan u kalben ose u mbuluan nga bari. Këto dy simbole dominojnë në poezinë e Gërvallës dhe janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën dhe si të tilla paraqesin kuptimin simbolik të jetës dhe ambientit, duke përfshirë këtu edhe simbolin e botës shpirtërore të vet poetit.

Në vitrinat e verdha nga drita një natë e kam parë mes do gjësënësh prej kashte dhe pëlhurash rrinte pak si e shtrembëruar mbi përfytyrimin dhe erë luleshqerrash shpërndante nëpër trotuar njerëzit ktheheshin nga turmat e natës të lodhura aty kishte drunj të vjetër dhe trungje rrezuar një shteg i ngushtë barin e kishte tharë me shkelje aty e pashë time ëmë me gotatë në dorë e vetmuar shkonte e gërmuqur shtegut drejt derës së saj.. ("Shtëpia në kornizë")

Derisa në dy vëllimet poetike

"Fluturojnë e bien" dhe "Kanjushë e verdhë" poeti shpreh mallin, dhembjen dhe dashurinë ndaj vendlindjes (Hapat e mi sot nuk shtegtojnë nuk shtegtojnë/fjalët e mia nuk fluturojnë si zogj pikëllimi... (Shtëpia rrezë malit), në vëllimin tjetër poetik "Shenjat e shejta" shprehet vetmia e brendshme e poetit.

Tutje gjithnjë akull kënde gjithnjë zjarr unë jam syri i Aladinit e shoh vetëm si digjem në betejën e tmerrshme të fjalës e të menduarit (Lufta dhe arti)

Poezia e Jusuf Gërvallës veçohet edhe me përdorimin e madh të figurave stilistike dhe në vargëzim (metrikë). Kjo poezi, konkretisht, veçohet me përdorimin e metaforave, epiteteve, anaforave, antitezave dhe pasthirmave. Disa nga përdorimet e tilla janë: "natës së lodhshme", "qiell i vdekur" (metafora epitete), "Tutje gjithnjë akull/ Kënde gjithnjë zjarr (antitezë), "Ka në shtëpinë time edhe mjaft dashuri të vjetër/ ka biruca të imëta tek strehohen minjtë (anafora), "O ju korba" (pasthirma), "hapat e mi sot nuk shtegtojnë nuk shtegtojnë" (epiforë), "A është më i bukur syri yt i përgjumur a livadhi? (pyetje retorike), "A është shtrati i ëmbël trupit im i verdhë/ a dërrasë e brejtur teje flakur në bodrum/ a e ka në ballë/ fenerin e kepin e pritur/ a e ka dritë në kënde nyje të shkapërderdhura... (asonancë) etj. Ndërsa, në anën tjetër, poeti Gërvalla gjatë vargëzimit përdor vargun e lirë, ndërsa vargu është 4, 6, 8, 9, 10, 11, 13, 16 dhe 17 rrokësh. Shumica e poezive të tij janë të vargëzuara në kolonë edhe në strofa. Strofata e përdorura në poezi janë të ndryshme, si: 3, 4, 5, 6, 8, dhe 13 vargësh.

Sipas analizës së bërë, në poezinë e Jusuf Gërvallës, trallë, shumë trallë gjejmë vargje të rimuar, si në rastin

"Në çatitë e kullës le të pikojë shi/ Le të vërë trashë cipa e të mëblit në kusi... (Bekimi i nënës).

Për fund. Poezia e Jusuf Gërvallës është lirikë e kulluar, e pastër dhe e çiltër, është poezi magjepse për lexuesin, është poezi shfryrëse të sinqertat si një larje hesapësh dhe preokupimesh të thella të shpirtit të poetit. (Ramiz Dërmaku, Wikipedia.org)

Në tri vëllimet poetike të Jusuf Gërvallës, por edhe në poezitë e tjera, të botuara jashtë këtyre vëllimeve poetike në gazeta dhe revista të ndryshme brenda dhe jashtë vendi trajtohen tema dhe motive të ndryshme dhe në përgjithësi dalin të arrira artistikisht.

Gërvalla në poezinë e tij shpreh fuqishëm dashurinë, dhembjen dhe mallin për vendlindjen, shtëpinë dhe nënën, ndërsa edhe vetmia është prezentë në disa poezi të tij.

Edhe una e fundit a kallë në votër, Po kangën ende s e kam mbarue, Kangën për ty, vendlindje - Burim i lotëve të mij të shkretët (Mali për vendlindjen)

Poezia e poetit Jusuf Gërvalla veçohet edhe me gjuhën dhe stilin e përdorur gjatë vargëzimit. Ai, duke përdorur shpeshherë fjalët në kuptimin e dytë apo figurativ, vetëm sa iu jep fuqi vargjeve të tij melankolike, por të këndshme.

Megjithatë, për veprimtarinë letrare të Jusuf Gërvallës, duke përfshirë këtu edhe poezinë e tij, deri më tani, mendoj, se nuk është shkruar sa duhet. Për këtë shkrimtar atdhetar dhe liridashës kërkohet të shkruhet shumë më shumë, sepse ky është edhe obligim yni dhe i pasardhësve tanë në trojet e Arbërit.

(Vështrim i lexuar në edicionin e tridhjetë e pestë të "Flakës së janarit", mbajtur në Pejë dhe organizuar nga Shoqata e Shkrimtarëve të Pejës dhe Klubi Letrar "Podguri" të Istogut)

## Përurohen dy libra kushtuar Adem Demaçit

PRISHTINË, 26 SHKURT - Me rastin e 82-vjetorit të lindjes së veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi, janë përuar të hënën dy libra të Selatin Novosellës "Viti i Adem Demaçit" dhe "Demaçi njeri i lavdisë".

Autori i librave, Selatin Novosella, ka thënë se ka pasur rastin të mbajë shumë përuarime por, sipas tij, ky i fundit për Demaçin është përuarimi më i kuptimshëm dhe më domethënës në jetën e tij. Novosella ka theksuar se angazhimi i tij për këta libra ka qenë me shumë pasion, me shumë dashuri, me shumë konsideratë për Demaçin. Ndërsa ish-kryetari i Shoqatës së të

Burgosurve Politikë të Kosovës, Berat Luzha, ka paraqitur një pasqyrim të shkurtër të veprimtarëve të shumta kulturore të organizuara në kuadër të 80-vjetorit të lindjes së Adem Demaçit.

Në anën tjetër, Shyqerri Galica, përfaqësues i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, ku Adem Demaçi është kryetar nderi, ka thënë se personaliteti i bacës Adem pa asnjë dyshim është i veçantë me një spektër të gjerë trajtimesh e hulumtimesh, një figurë dramatike nga jeta e hershme e tij e deri në ditët e sotme me ide dhe pikëpamje tejet të veçanta e, mbase, ndër më konstruktive në historinë e kombit

shqiptar.

Ndërkaq drejtori i Institutit Albanologjik, Hysen Matoshi, ka thënë se rëndësia e këtyre librave për Demaçin qëndron në faktin se janë bërë përpjekje të mëdha që të mbledhen në një vend të gjitha aktivitetet e vitit jubilar për Demaçin.

Në këtë promovim organizatorët kanë lexuar mendimin e Pjetër Arbënorit, ish- kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, për veprimtarin Adem Demaçi. "Ju i dashur Adem jeni nga ata intelektualët dhe veprimtarët shqiptarë që tërë jetën ia keni kushtuar, pa më të voglën rezervë, idealit të shenjtë të lirisë. Keni mposhtur



burgun gati 30-vjeçar brenda hekurave mbytës të shovinistëve serbo-mëdhenj. Jeni kthyer në simbol të qëndrësës, të ndershmërisë, dhe tash qëndrori kryelartë në rreshtat e parë të rezistencës

paqësore që populli heroik i Kosovës të fitojë hap pas hapi të drejtat e veta njerëzore e kombëtare dhe të bëjë realitet aspiratat e natyrshme për liri, pavarësi e bashkim kombëtar".

## Ish e fejuara e Ronaldos flet për jetën që ka pasur me të



**I**sh e fejuara e Cristiano Ronaldos, Nereida Gallardo, ka zbuluar detaje interesante mbi sulmuesin portugez të Realit të Madridit. Ajo ka rrëfyer se CR7 nuk preferonte përdorimin e prezervativëve dhe se është shprehur e bindur se fëmija i parë i portugezitet është fryt i pakujdesisë. "Ai nuk preferonte

përdorimin e prezervativit dhe fëmija i parë i tij nuk është i një nëne surrogato, por fryt i pakujdesisë me kamerieren", ka thënë Nereida. Pyetjes nëse portugezi është homoseksual, Nereida Gallardo iu përgjigj: "Sa kohë ishte me mua, mund t'ju siguroj që jo. Më vonë, nuk e di...".



## Demi ua jep dhuratën e radhës 6.4 milionë fansave

**F**ama e saj është në rritje të vazhdueshme dhe kjo reflektohet më së miri në "Instagram", ku ka arritur tashmë 6.4 milionë ndjekës. Demi është

fotografuar së fundmi në Itali. Ajo ka ndarë disa fotografi për fansat në "Instagram", ku i lë pak vend imagjinatës, duke u ekspozuar më shumë seç duhet.

## Lawrence tregon për planet që ka për të ardhmen



**A**ktorja e njohur Jennifer Lawrence ka treguar se është duke përgatitur një seri dokumentarësh televizivë. Ajo këtë njoftim e ka bërë rastësisht, derisa ishte duke folur për

filmin "Red Sparrow", raporton "Bazar". "Nuk doja ta bëja këtë paralajmërim, por ja që e bëra", ka thënë ajo. Më tej Lawrence ka hezituar të tregojë për hollësitë dhe për përmbajtjen e këtyre serive.

## Kylie Jenneri pranon dhuratë një veturë luksoze




**K**ylie Jenneri ka bërë me dije se ka pranuar një dhuratë tejet luksoze. Ajo ka postuar në rrjetet sociale fotografinë e automjetit të saj të ri që kap vlerën rreth 1.4 milion dollarë. Kylie ka treguar se vetura është një dhuratë për lindjen e foshnjës së quajtur Stormi.

# Karikaturat holandeze në vitin 1990: Sinjale nga Shqipëria!


**Nga Armand PLAKA**

Vendet e tjera të ish-Lindjes, ku shumë syresh tashmë po përjetonin fazën e fundit të një trendi thujse romantik të komunizmit në krahasim me atë shqiptar, të gjitha i kishin hipur tashmë "trenit të ndryshimeve". Shqipëria ndërkaq, ndodhej akoma në një udhëkryq vetmitar dhe frika, pasiguria dhe hija e Sigurimit ishin ringjallur edhe më shumë në një vit, i cili do të

ishte dhe i fundit, përse i përket mbajtjes më këmbë në terma realë të regjimit më diktatorial që kontinenti kishte njohur në gjysmën e dytë të shekullit të shkuar. Shtypi perëndimor kishte nisur ndërkaq të merrej më shumë me Shqipërinë e prania e saj në faqet e tij po bëhej gjithnjë e më e madhe, duke sjellë shpesh edhe të vërteta gjysmake, por sidqoftë, gjithkush e kishte të qartë se tashmë ena ku ziente uji i komunizmit shqiptar, ishte mbushur plot e pritej të derdhej nga dita në



Signalen uit Albanië



ditë. Vendi po shkonte drejt fundit e kjo vihet re edhe në një karikaturë të medias holandeze të janarit 1990, ndërsa shihet silueta e një sigurimi që mban në duar një flamur me fotot e Stalinit dhe Hoxhës, hipur mbi shpinën e një fshatari shqiptar, duke shkuar të dy drejt një gremine të thellë, e cila preseupozonte fundin e pashmangshëm e të

pashpresë të rrugës që vendi kishte nisur prej shumë dekadash. Në të, megjithatë nuk shihen shenja dëshire për ndryshim, apo ndonjë rezistencë. Ndërkaq, në një tjetër karikaturë të korrikut 1990, menjëherë pas asaj që njihet tashmë si "kriza e ambasadeve", duket se mesazhi është më i qartë, ndërsa skicohet në mënyrë satirike simboli i drapërit

dhe çekanit, i cili sa nuk po shqyhet nga përpjekja e dy njerëzve për të mos i lënë më ata të bashkëjetojnë, dmth. të mbijetojnë.

Të dy imazhet i kam hasur prej kohësh, ndërsa rrëmoja në medi- at perëndimore për "reliqe" që lidhen me Shqipërinë moniste dhe shfaqen kështu për herë të parë për publikun shqiptar.

(gazeta-Shqip.com)

## 'Pantera e Zezë', një film me superheronj në Afrikë

Filmi me superheronj "Black Panther", "Pantera e zezë" e regjisorit Ryan Coogler, bazuar në librin me ilustrime Marvel, ka ne qendër mbretin e një vendi të përparuar teknologjikisht në Afrikë. Aftësitë e tij të mahnitshme në luftë përforcohen edhe më shumë nga fuqitë e tij prej superheroi dhe një kostum i veçantë. Filmi që kushtoi 200 milionë dollarë për t'u realizuar, është pritur me interes të madh në të gjithë botën për efektet speciale, aktorët dhe veçanërisht homazhin ndaj kulturës afrikane. Ngjarjet janë të vendosura në Wakanda, një vend i vogël imagjinar afrikan, që fsheh një sekret të madh. I ndërtuar mbi Vibranium, metali më i fortë në botë, Wakanda ka teknologjinë dhe fuqinë që asnjë vend tjetër nuk e ka parë ndonjëherë.

"Ajo që ndodh tani përcakton se çfarë i ndodh pjesës tjetër të botës".

Pasi i vdes babai në një sulm terrorist, T'Challah, që interpretohet nga Chadwick Boseman, fiton superfuqitë e Panterës së Zezë dhe bëhet mbreti i ri. Regjisor Coogler ka krijuar një superhero bashkëkohor afrikan.

"Çilat janë cilësitë e Panterës së Zezë? Ai ka përgjegjësi të politike,

kostumin magjik, putrat, forcën. Ai është afrikan dhe kjo e bën atë të veçantë."

Filmi paraqet rreziqet dhe përfitimet e një izolacionizmi politik të një vendi të përparuar. A duhet ta ndajë Wakanda fuqinë dhe teknologjinë e saj me pjesën tjetër të botës? Apo t'i fshehë dhe t'i mbrojtë burimet e saj nga të huajt? "Është përgjegjësia ime që të sigurohem që Wakanda të mos bjerë në duart e një personi si ju", thotë në film T'Challah, Pantera e Zezë. Linja e rrëfimit dhe heroit me ngjyrë kanë magjepsur audiencat në të gjithë botën, thotë Lupita Nyong'o që interpreton Nakian, një agjente e Wakandas me të cilën ka rënë në dashuri T'Challah.

"Bëhet fjalë për një univers që e shpalojmë me krenari të qenurit afrikan. Dhe është frymëzuese që ne jetojmë në një vend afrikan me mbretër, mbretëresha dhe luftëtarë. Një vend që e aspirojmë që e rigjallëron shpirtin njerëzor", thotë aktorja Nyong'o.

Në një intervistë për Zërin e Amerikës, producenti i "Panterës së Zezë", Nate Moore dhe disenjatorja dhe kandidatja për Oscar, Ruth Carter tha se të gjithë krijuesit dhe aktorët e filmit donin që të realizonin një film që nxirrte në



pah një kulturë krenare të bukur dhe të zgjuar afrikane.

"Është bërë e zakonshme që në kinema, historitë për Afrikën janë për varfërinë, për plaçkitjen e pasurive të saj. Por këtu, ky është vendi më i përparuar teknologjikisht në botë. Është një model i mrekullueshëm për fëmijët".

Kostumet shumëngjyrëshe të Carterit, pasqyrojnë traditën amerikane dhe i bëjnë personazhet madhështore, veçanërisht gratë.

"Bëhet fjalë për luftëtarë të vërtetë, gjeneralë që kanë armë. Duhet të veshin mburoja, por ne i krijuam

ato në mënyrë të tillë që të duken të bukura. Prandaj, ngjyrat feksin dhe mburojat duken si stoli të çmuara. Ato lidhen në trup në një mënyrë që i bën homazh historisë së personazheve". Moore thotë se aktorët dhe krijuesit e filmit u kujdesën për çdo detaj.

"Ne bëmë çdo përpjekje, kishim konsulentë kulturorë dhe shumë nga aktorët tanë janë nga Afrika. Madje edhe konsulentja për dialektin, Beth MacGuire, dhe i gjithë kasti donte që të tingëlonte nga Afrika. Megjithatë mendoj se afrikano-amerikanët mund ta

identifikojnë veten me filmin. Shpresoj që të gjejnë frymëzim, duke mësuar se ku i kanë rrënjët afrikano-amerikanët".

Në shkollën e mesme "T.C. Williams" me një trupë të larmishme nxënësish pranë Uashingtonit, të rinjtë janë entuziastë për filmin.

"Jam shumë entuziaste. Më duket se i përçon mesazhin fëmijëve dhe shoqërisë në përgjithësi se askush nuk lind racist. Dhe me këtë film, sikur u mësohet që të mos jenë të tillë", thotë Jeincy Paniagua.

"Unë mendoj se është shumë e rëndësishme jo vetëm për vajza të reja në përgjithësi, por për vajza të reja me ngjyrë, individë me ngjyrë që të shohin se si janë të përfaqësuar në media dhe mendoj se u jep një ndjesi force".

"Por edhe të tregojmë se cilët jemi si popull. Jemi superheronj sipas modelit tonë, dhe kjo është provuar tek marshimet, protestat që ne nuk jemi thjesht pakicë por pjesë e shumicës".

Falë mesazhit për krenarinë afrikane, apo atij për fuqizimin e gruas, ky film që ishte pritur me padurim, pritet të ketë një sukses të jashtëzakonshëm në kinema, në universin e filmave me superheronj. (gazeta-Shqip.com)/VOA



# Udhëto në Nju Jork, aty të pret një burrë për ta dashuruar

**U**dhëto në Nju Jork, aty do të gesh burrin e ëndrrave. Pas shumë zhgënjimeve Leonora Carrington e dinte se një biletë për Nju Jork mund t'i ndryshonte jetën. Është historia e jashtëzakonshme e jetës së një prej artistëve më të njohura e cila kujtohet sot përmes pikturave dhe letërsisë që la pas. Leonora Carrington u lind në Lancashire në Angli dhe gjatë gjithë jetës së saj kërkoi aventurën. Babai i saj ishte një prodhues tekstilësh, ndërsa nëna irlandeze. Një rol të rëndësishëm në krijimin e përfytyrimeve të saj të para ka luajtur edhe dadoja e saj irlandeze, Mary Cavanaugh. Që fëmijë ajo ka jetuar e përfshirë nga ëndrrat për një shtëpi të treguar nga dadoja që quhej Crookhey Hall. Në këtë shtëpi ajo shkonte shpesh me ëndrra deri në adoleshencën e vonë, pasi aty ndodhej një botë tjetër e krijuar prej saj... E edukuar prej murgeshave, ajo u përjashtua nga shkolla për sjelljen e saj rebelle dhe u dërgua nga familja për të studiuar në një akademi arti në Firence. Babai i saj e kundërshtoi që në fillim prirjen e saj ndaj artit, por e ëma e inkurajoi atë. Pas kthimit në Londër ajo u fut në një shkollë arti në Chelsea. Në ekspozitën ndërkombëtare të artistëve surrealistë në Londër më 1936-n, ajo u magjeps nga punët e artistit Max Ernst. Një vit më vonë do të takohej me të në një mbrëmje në Londër dhe do të binte në dashuri. Ajo mbrëmje është përshkruar në piktura të dy artistëve më vonë. Duke përfituar nga historia e dashurisë me surrealistin e



njohur gjerman Max Ernst, ajo u largua drejt Parisit, ku do të pranohej menjëherë si pjesëtare e rrethit të surrealistëve. Në fillim të vitit 1938, ajo merr pjesë në ekspozitën më të madhe franceze surrealistike me dy punime të saj: pastaj në Amsterdam etj. Po në këtë vit botohet në Paris edhe tregimi i saj i parë: "Shtëpia e frikës". Në vitin 1939, botohet libri me tregime "Zonja ovale", ku përfshihen tregime të tilla si "Debutantja", "Urdhri mbretëror", "Dashnori" etj. Në vitin 1940, do të botohen edhe dramata e para të Leonora Carrington, një pjesë e të cilave nuk u është gjetur dorëshkrimi origjinal në anglisht. Në shtator 1939, menjëherë pas mbarimit

të Luftës së Dytë Botërore, Max Ernst, duke qenë nënshtrë dhe një figurë e njohur, shihej si një rrezik potencial për francezët, të cilët do ta arrestojnë disa herë dhe do ta ndjekin vazhdimisht me pretekstin se është një nga spiunët e nazistëve. E lodhur nga lufta dhe rreziqet e të dashurit të saj të zemrës (me të cilin bashkëjetonte prej disa vitesh), njëzetetrevjeçarja Carrington bie në depresion të thellë dhe me ndihmën e të atit, një borgjez anglez shumë i pasur dhe me influencë të madhe, arrin të largohet nga Franca dhe shtrohet për t'u kuruar në një klinikë në veri të Spanjës. Sapo e kishte marrë veten, nën mbikëqyrje të plotë, ajo largohet drejt

Portugalisë, ku kërkon strehim në ambasadën meksikane e më pas përfundon në Nju Jork. Ndërkohë është ndarë nga Maks Ernsti. Nju Jorku solli një jetë të re për Leonorën. Ajo fantazonte pa kufi, por ëndërronte të jetonte në Meksikë, ku edhe jetoi pjesën më të madhe të jetës së saj. Sa arriti aty ajo u mor me studimin e kulturës


Meksikë, Leonora u martua me Emericko Weisz, me të cilin pati dy djem. Gabriel Weisz një intelektual dhe poet, dhe Pablo Weisz, një artist surrealist dhe doktor. Gjatë gjithë jetës së saj, Leonora ishte në kërkim të rrëfimit artistik. Ajo lexoi, udhëtoi, shkroi dhe pikturoi. "Në jetën time unë nuk kam kohë për të qenë muza e askujt. Kam qenë e



indiane, me prejardhjen e tyre dhe më tepër me mistikën e kulturës Maja. Të gjitha përshtypjet e saj, Carrington do t'i paraqesë në tregimet dhe pikturat e asaj periudhe. Në vitet 1970-1980, Carrington ndërmori një sërë udhëtimesh në Amerikë dhe Evropë, kohë kur ajo filloi të botohej dhe të bëhej e njohur si shkrimtare e fantastikës, si shkrimtare e humorit të zi. Disa zëra e renditën atë përkrah Lewis Carroll-it (autor i "Liza në botën e çudirave") apo shkrimtarë të tjerë surrealistë. Leonora nuk është vetëm një nga femrat më të spikatura të surrealizmit në pikturë (përkrah Frida Kahlos) dhe letërsi, por ajo është në veçanti një figurë e rëndësishme e kësaj rryme. Oktavio Paz do të shkruante për të: "Heroinat romantike, të bukura dhe të frikshme, si ato të Karolinë von Gunderode, ringjallen te gra të tilla si Leonora Carrington". Në

zënë duke u rebeluar ndaj familjes sime, dhe për të jetuar si artiste", do të shprehej ajo më 1983-shin. Nuk ishte vetëm letërsia që shkroi ajo që e bëri Leonorën një artiste të dashur, por dhe pikturat që realizoi. Kishte diçka magjike në mënyrën sesi ajo ndërtonte një tablo, diçka që të bënte ta doje. Pikturat e saj ishin mistike, gjë që ndihej dhe në tregimet që Leonora shkroi. Për të nuk kishte ndonjë ndryshim midis shkrimit të një tregimi apo një pikturë. Për të ishin një proces i ngjashëm. "Ti mund të hedhësh ndjenjat e tua në pikturë, por dhe mund ti hedhësh në një kartë... të dyja këto procese vijnë natyrshëm tek unë, dhe ndonjëherë më duken të ngjashme", shprehet Leonora. Për të, piktura dhe e shkruara ishte një nevojë, jo një zgjedhje. Leonora Carrington vdiq në Meksikë, më 25 maj 2011.

(gazeta-Shqip.com)



<b>EPOKA E RE</b>						<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>	NJËSOJ; PO AQ, NË TË NJËJTËN MADHËSI A SHKALLË ME NJË TJETËR	LLOJ GËLQERORI (min.)	NDARJE E VOGËL ADM-INISTRATIVE BRENDA RRETHIT	STUDIM ME KARAKTER KRITIK OSE PUBLICISTIK	BASHKËT.	<b>EPOKA E RE</b>	PO (IT.)	PJESËTARËT E NJË SHOQATE	QË ËSHTË NË MIRË EKONOMIKE; I .....	GJENDJE QË KRIJOHET KUR MUNGON PUSHTETI SHTETËROR I ORGANIZUAR	HISTORIANI ROMAK LIVI
						ARTI I VALLEVE ME FIGURA, QË LUHEN NË SKENË NGA DISA VETA						I GJYMTË KONFERENCË ME KARAKTER NDERKOMBËTAR					
						PRAROJ					KËNGËTARI ..... HOXHA (shq.) QYTËT I YNI NË MAL TË ZI						
						FISHEKZJARRI QË HIDHET LART PËR TË DHËNË SHENJA							NËNAT ZANORE				
						TITULL PËR OFICERË NË USHTRINË E VJETËR TURKE				QË I PESHON MIRË VEPRIMET A FJALËT; I KUJDESSHËM I KËPUTUR							ISH FUTBOLLISTI ..... RRAKLI
						SHTET NË AMERIKËN JUGORE (pashq.)							KASA BANORET E NJË SHTETI AZIATIK				
						PUNËTOR I TEATRIT TË KUKULLAVE									ILIJON LIKA PJESE E MEKANIKËS QË STUDIOJ LIGJET E LEVIZJES SË TRUPAVE		
						KALORËS MESJETAR						MINISTRY OF ECONOMIC DEVELOPMENT TEPسيا PREJ BALTE					BASHKËT. BRITMË E LOPËS
<b>EPOKA E RE</b>	FUTBOLLISTI URUGUAIAN NË FOTO (Barcelona)	KËNGËTARJA ..... TOSKA	KAP DIÇKA TË PJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDE	PAGJAKËSI	SLOGAN	ALUMIN, URAN	QË NUK PLOT-PJESËTOHET ME DY (pashq.) ROK BEND AMERIKAN				FORMË E TË HYRAVE SHTETËRORE (shq.) ALEANCË						
	PJESË E BANJËS							DAULLE BASHKËT.						KUMBARË RUBA, MARAMA			
	GUR METEORIK								PROVINÇË NË ITALI ANËTARËSIMI NË NJË ORGANIZATË							AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBRËN	PJESËTARI I NJË POPULLI NË SRI LANKË
	I SHKRIRË (PËR LËNDË TË NGURTA)							ZANORE SHTET FEDERAL NË SHBA	BURG KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA PËREMËR PRONOR								
	SILIC		"MOLDE" NAPOLI ATALANTA			UJIT LLOJ SHEQERKE						GJINI E KRIJIMTARISË LETRARE AUTORITETI ATOMIK SHQIPTAR					
	KËNGËTARJA .... MALAJ					LAPS PJESË E FORTË E BUKËS					SULMIM SHKURTABIQ						
						LLOJ ZOGU KËNGËTAR FLEGËR							KATËR (romak)	LETRARI ASLLANI INTERESI BANKAR NGA KREDIA			
	SHPEND SHTËPIAK SHKRONJA TË NJËJTA		MAL I MADH NË SHQIPËRI VOZA E MADHE PËR TË MBAJTUR DJATHË						DASHNOR (bised.) AKTORI FRANCËZ ..... DELON (shqip.)					IRMA LIBOHOVA DUET MUZIKOR KONTROVERS (fem.)			
	BASHKËT.	AKTROJA AMERIKANE ..... REID					TË LUTEM (bised.)					NJËSI PËR MATJEN E FUGISË SË RRYMES TOKË E FEUDALËVE SPAHINJ			ZANORE PESHORE ME DY KRAHË TË BARABARTË DHE ME DY PJATA		
	REPER I NJOHUR AMERIKAN						QYTET I YNI NË SHQIPËRI MI I VOGËL						LUMË NË SHQIPËRI CEREMONITË FETARE				NDESHJE
	MODELJA KRASNIQI					SOLISTJA ... BYTYQI I NDESH			PRINCIPATË ARABE (sh.shq.) KËNGËTARI POTOKU								
<b>EPOKA E RE</b>	GJAKATARI RAST							E SHASTISURA ISMET RAMUSHI									
	KA, DEM			TENISTJA BELGE JUSTINE VARIOLE					SËPATË E VOGËL ME TEH TË GJERË MARC ANTHONY						EKREM KRYEZIU "IRLANDA"		
	PRJËS I HUNËVE					PËRGËZIM ZANORË					VRRANËSIRË BASHKËT.		NEGËR ZANORË				
	"RISANI"		SHKENCËTARI ..... NJUTON					KLUB FUTBOLLI ARGJENTINAS ... LORENZO				TRAJNERI TURK FATIH .....					

E jashtëzakonshme

## Kuzhinieri i famshëm që filloi karrierën si pjatolarës i pastrehë

Kuzhinieri Alan Geam flinte në një park në Paris dhe punonte si pjatolarës, por pas një kohe i erdh mundësia për t'u promovuar si kuzhinier. Shefi i kuzhinës së restorantit ku Alean punonte, lëndoi veten me një thikë dhe Alanit iu hap rruga për ta treguar veten si kuzhinier. Ai pas një kohe u bë kuzhinieri më i kërkuar në Paris. Alean arriti të fitonte një mirënjohje për restorantin ku punonte në kryeqytetin francez.



FOTO E DITES



Skiatorit zviceran Benjamin Weger i ngrihet mjekra gjatë Lojërave Olimpikë Dimërore në Korenë e Jugut. /Reuters/

E rrallë

## Macja me "dy fytyra"

Pa dyshim se do të bini në dashuri me këtë mace të adhurueshme me "dy fytyra". Fytyra e saj me dy ngjyra, e zeze dhe gri, duket e përkryer dhe ka fituar zemrat e të gjithëve. Macja mendohet se ka ADN të ndryshme nga secila anë e fytyrës. Kjo mace e quajtur Muggy është fotografuar nga fotografi Jean-Michel Labat.



## BARSOLETA E DITËS



- Flasin dy gjyshe:
- Sa peshon?, - e pyet njëra.
  - Me syze, 80 kilogramë.
  - E pa syze?
  - Eh, pa syze, nuk e shoh peshoren.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00

## "FERDINAND"

3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.

Regjia: Carlos Saldanha



## Në ora 18:00 dhe 20:00 (R) "FIFTY SHADES FREED"

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.

Regjia: James Foley

Në ora 22:00 (PG-13)

## "THE COMMUTER"

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.




**DASHI**

Keni lajme të mira që doni t'i ndani me të gjithë. Do ta merrni përkrahjen e personave që ju duan dhe ju mbështesin.



**DEMI**

Këtë ditë doni të merrni përgjegjësi të reja mbi vete. Planet tuaja do t'i konsultoni me partnerin.



**BINJAKËT**

Sot gjatë ditës do t'ju shoqërojnë persona të gëzueshëm dhe mjaft të vendosur.



**GAFORRJA**

Sjellja juaj ju çon drejt një drejtimi që nuk ishte parësor. Gjithsesi, është më i mirë se i mëparshmi.



**LUANI**

Sot mjafton t'i ndani mirë oraret e ditës dhe çdo gjë do t'ju shkojë siç dëshironi. Partneri ka një kërkesë për ju.



**VIJGJËRËSHA**

Objektivat e ditës suaj përqendrohen vetëm tek puna. Mos harroni që edhe familja ka të njëjtën rëndësi.



**PESHORJA**

Ditën e sotme duhet të gjeni aleatë të fuqishëm për të mbrojtur një projekt që ka kundërshtitë e veta.



**AKREPI**

Nëse doni të merrni në dorë fatin tuaj sot, mundohuni t'i qartësoni disa situata të dyshimta.



**SHIGJETARI**

Në ditët e shkuara keni bërë një gabim që do t'ju duhet pak kohë për ta rikuperuar. Gjithsesi do të dini si të veproni.



**BRICJAPI**

Sot një çështje financiare do t'ju shkaktojë shumë stres. Nëse ju kap paniku, nuk do të arrini të zgjidhni gjë.



**UJORI**

Nëse keni mundësi për të mbaruar punë sot mos e neglizhoni. Koha nuk ju premtonte për të gjitha projektet tuaja.



**PESHQIT**

Sot do të bëni zgjidhje që shkojnë ndesh me ato që vendosni zakonisht. Zgjidhjet do të rezultojnë mjaft produktive.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	HULL - BARNSELEY	1	BRISTOL ROVERS - WIGAN	2	WYCOMBE - COVENTRY	1
-------------------	------------------	---	------------------------	---	--------------------	---

# Zhdrella: Llapi, favorit për titull

Humbja nga Prishtina (2-0) dhe nga Drita (0-1) nuk e zbraps aspak skuadrën e Llapit nga gara për titullin e kampionit. Kështu ka shprehur mendimin mesfushori Mentor Zhdrella. "Për Kupë kemi nisur mirë, por për kampionat kemi dështuar në dy ndeshjet e para. Megjithatë, synimet tona për titull nuk zbehen aspak. Normalisht se jemi ndër favoritët kryesorë në garën për më të mirin e elitës", ka thënë Zhdrella

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Futbollisti Mentor Zhdrella, një ditë pas humbjes me Dritën (0-1), në kuadër të Vala Superligës së Kosovës në Futboll, ka thënë se në skuadrën e Llapit kishin pritur se do të jetë një ndeshje e vështirë por, sipas tij, i rëndësishëm është fakti se diferenca e pikëve në mes të skuadrave të para në tabelë është e vogël. "E kemi ditur se ndeshja ndaj Dritës do të jetë e vështirë sepse edhe ajo, sikurse ne, është skuadër cilësore dhe ka synime të mëdha në këtë kampionat. Fusha nuk ishte në gjendje të mirë. E dinim se një gol mund të vendoste në ndeshje. Jemi mundur të mos e humbim ndeshjen, por nuk kishim sukses. Me rëndësi është se diferenca e pikëve në mes të skuadrave është e vogël dhe ky kampionat do të jetë interesant deri në fund", ka thënë Zhdrella për "Epokën e re".

Llapi sezonin pranveror e nisi me fitore për Kupë ndaj Trepçës '89, kurse për kampionat pësoi dy humbje radhazi nga Prishtina dhe Drita. Megjithatë, Zhdrella, që është lojtari që ka fituar trofe më së shumti në aspektin personal në vend, ka thënë se këto humbje nuk e zbehin aspak synimin e Llapit në garën për titull. "Për Kupë kemi nisur mirë, por për kampionat kemi dështuar në dy ndeshjet e para. Megjithatë, synimet tona për titull nuk zbehen aspak. Normalisht se jemi ndër favoritët kryesorë në garën për më të mirin e elitës", ka thënë Zhdrella.

Në xhiron e radhës Llapi i Tahir Batatinës i shkon Flamurtarit, kurse për këtë ndeshje Zhdrella konsideron se fitorja është një obligim për skuadrën e tij. "Skuadra e Flamurtarit është shumë e fortë, ani pse tabela nuk e tregon një gjë të tillë. Ne do t'i qasemi me seriozitetin më të madh kësaj ndeshje dhe e duam fitoren e parë në pranverë", ka deklaruar ai.

Në çastet e fundit të ndeshjes Llapi -



Drita është lënduar talenti Mirlind Daku, i cili është dërguar me ambulancë në spital. Zhdrella ka siguruar tifozët llapjan se asgjë serioze nuk është me lëndimin e supertalentit Mirlind Daku dhe ai së shpejti do të jetë në dispozicion të trajnerit Batatina. "Sipas mjekut, lëndimi i Dakut nuk është aq serioz dhe

ai shumë shpejt pritet të jetë i gatshëm. Bëhet fjalë për një lojtar cilësor dhe ky është lajm i mirë për Llapin", ka përfunduar Zhdrella.

Aktualisht Llapi pozicionohet në pozitën e tretë në tabelën e elitës me 34 pikë, kurse ka dy pikë më pak se Drita dhe Prishtina.

## SHKURT

### Shtyhet ndeshja Vllaznia - Drenica

Ndeshja e fundit e javës së 20 në Vala Superligën e Kosovës në futboll ndërmjet Vllaznisë dhe Drenicës është shtyrë për shkak të reshjeve të mëdha të borës. Këtë vendim e ka marrë Komisioni i Garave në Federatën e Futbollit të Kosovës (FFK), kurse kjo ndeshje do të zhvillohet sot (e martë) në orën 13:00.

### Ndërroi jetë trajneri Ahmet Behrami

Trajneri i njohur Ahmet Behrami ka ndërruar jetë në moshën 63-vjeçare, ndërsa lajmi është bërë me dije nga familja e tij. Behrami ishte punëtor i palodhshëm, zbuluesi i shumë talenteve dhe gjeneratave "minatore". Ngushëllime ka shprehur ish-skuadra e tij, KB Trepça. "Me dhembje dhe pikëllim të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta të ish trajnerit tonë, Ahmet Behrami. Në emër të Klubit të Basketbollit 'Trepça' i shprehim ngushëllime familjes Behrami", thuhet në telegramin e ngushëllimit të skuadrës mitrovicase.

### Neville kritikon Xhakën, Ramseyn dhe Ozilin

Legjenda e Manchester Unitedit, Gary Neville, e ka kritikuar Granit Xhakën, Aaron Ramseyn dhe Mesut Ozilin, për paraqitjen e tyre ndaj Manchester Cityt, pas humbjes nga Manchester City (0-3) në finale të Carabao Cup. "Shikojeni Ramseyn, ai po ecën. Xhaka po ecën. Ozili po ecën. Mos ecni në 'Wembley'. Mos ecni në fushë futbollit. Është e pabesueshme. Vraponi", ka thënë Neville për "BT Sport", gjatë analizimit të ndeshjes. "Shikoni Xhakën dhe Ramseyn se si po kthehen prapa duke ecur, kurse ata janë mesfushorë qendrorë. Një minutë para se ta pësonin gol u tregova se Xhaka dhe Ramsey po ecnin. Ata janë një turpërim, ata janë... Të ecësh në 'Wembley', të dorëzohesh. Kjo ishte një ditë e zezë, e zezë për Arsenalin", ka deklaruar Neville.

## Khaka u dhuron fanella Jasharit dhe Lladrovci

**LONDËR, 26 SHKURT** - Futbollisti i njohur shqiptar Granit Xhaka ia ka dhuruar fanellën me numër 29 që e bartë tek Arsenalin, kryetarit të Skenderajt, Bekim Jashari dhe kryetarit të Drenasit, Ramiz Lladrovci. Të dy kryetarët, Jashari dhe Lladrovci, ishin të pranishëm të dielën në ndeshjen finale të

Kupës në mes të Arsenalit dhe Manchester Cityt. "Në ndeshjen e mbrëmshme, ku ishim spektatorë në ndeshjen finale të Arsenalit, me ftesë të miqve tanë shijuam një atmosferë të veçantë. Graniti dëshmoi se ishte lojtari më i spikatur në ekipin e tij. Ai të bën të ndihesh krenar me të. Pavarësisht prej

angazhimeve të tij, sot Graniti e kaloi një mëngjes të përbashkët me mua dhe Ramizin. Ai na dhuroi dy ndërresat e tij, të ndeshjes së mbrëmshme, nga të dyja pjesët e lojës. Po ashtu, Graniti ia dhurova një simbol të familjes. Faleminderit! Krenar me Granitin!", ka shkruar Jashari në rrjetin social "Facebook".



## Kosova pësoi humbje të thellë nga Lituania

Prishtinë, 26 shkurt - Përfaqësuesja e Kosovës pësoi humbje të thellë nga Lituania (106-50), në kualifikimet për Kupën e Botës në basketboll. 28-19 përfundoi çereku i parë për vendasit, të cilët edhe në çerekun e dytë fituan me rezul-

tat 20-8, kurse rezultati pas pjesës së parë ishte 48-27. Në çerekun e tretë vendasit sërish ishin më të mirë se Kosova duke fituar me rezultat 26-12, kurse në dhjetë minutëshin e fundit 32-11, ndërsa rezultati final 106-50. Kosova pas katër ndeshjeve

është e fundit në Grupin C më vetëm katër pikë. Dritarja e Tretë e kualifikimeve evropiane do të zhvillohet në fund të qershorit dhe në fillim të korrikut, ndërsa Kosova e pret në Prishtinë, së pari Hungarinë dhe më pas Poloninë.



## Mazreku: Premtimi i kryeministrit të jetësohet sa më shpejt

PRISHTINË, 26 SHKURT - Zëvendësministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Rexhep Mazreku, e ka vizituar skuadrën e Prishtinës. Ai është pritur nga nënkryetari i bordit Ahmet Kurtolli, anëtar i bordit Fikret Maqastena, drejtori gjeneral Sokol Krasniqi, sekretari Fatos Hoxha dhe drejtori sportiv Arsim Thaqi. Drejtuesit e skuadrës kryeqytetase ia ripërsëritën kërkesat drejtuar Ministrisë lidhur me situatën e pavolishme në infrastrukturë të FC Prishtina.



Zëvendësministri Mazreku ka thënë se e ka marrë një iniciativë për t'i takuar të gjitha drejtoritë e sportit nëpër komuna, për t'i parë problemet nga afër, për gjendjen aktuale në këtë fushë. "Kam marrë iniciativë të krijoj në program pune dhe të takohem me të gjitha drejtoritë e sportit nëpër komuna, për t'i parë problemet nga afër, për

gjendjen aktuale, sidomos për futbollin e infrastrukturën e saj si sportin më masiv në vend. Dua të bëj përpjekje për ta ndryshuar gjendjen aktuale, sepse sporti, sidomos futbollin, është shkollë edukimi në vete, që largon fëmijët nga rruga, ndërsa tani edhe mund të arrihet shumë më larg dhe më suk-

sesshëm në shkollimin e talenteve", ka thënë Mazreku. "Po ashtu, shpresoj shumë se premtimi i kryeministrit Haradinaj të jetësohet sa më shpejt, e që klubit më të madh në vend, FC Prishtinë, t'i jepet në shfrytëzim parcela e kërkuar për ndërtimin e kompleksit sportiv", ka deklaruar Mazreku.

## Houstoni s'di të ndalet. San Antonio rikthehet te fitorja

HOUSTON, 26 SHKURT - Houston Rockets nuk di të ndalet në kampionatin amerikan të basketbollit, NBA. Skuadra teksane mposhti Denverin në "Pepsi Center", 119-114, duke regjistruar fitoren e 12 radhazi. James Hardeni ishte në formë të shkëlqyer në këtë përballje dhe këtë e tregojnë 41 pikët personale të shënuara, ndërkohë që mjaft mirë u paraqitën edhe Chris Paul e Trevor Ariza, që shënuan respektivisht 23 dhe 14 pikë. Pas kësaj fitoreje, Houstoni ruan kryesimin në klasifikimin e Konferencës së Perëndimit. Forma e mirë e LeBron Jamesit nuk i mjaftoi Cleveland Cavaliersit në përballjen me San Antonio Spursin. "Mbreti" pati një bilanc me 33 pikë e 13 topa në tabelë në këtë përballje, të cilën në fund e fitoi skuadra e Gregg Popovichit me rezultatin 110-94. Për teksanët shkëlqeu Aldridge, me 27 pikë, ndërkohë që dhanë kontributin e tyre në këtë sukses edhe Green, me 22 pikë, e Murray me 13. Për Clevelandin, përveç Jamesit, u paraqitën mirë edhe Clarksoni



me 17 pikë dhe Jeff Greeni me 14. Me këtë rezultat, San Antonio, që është forca e tretë e Konferencës së Perëndimit, i dha fund serisë prej katër humbjeve radhazi. Fitore shënoi edhe Charlotte, që në "Spectrum Center" mposhti Detroitin 114-98, duke shënuar fitoren e katërt radhazi. Këto dy skuadra, që luftojnë për një vend në zonën e "play off"-eve në Konferencën e Lindjes, zhvilluan një lojë të hapur, por ishte Charlotte ajo që kishte një

marsh më shumë, teksa krijoi një avantazh prej 24 pikësh në fund të dy periodave të para, gjë që u mjaftoi "hornets"-ave për ta fituar sfidën. Për Charlotte, më të mirët në parket ishin Walkeri me 17 pikë, Howardi me 17 pikë e 12 topa në tabelë, e Batumi me 15 pikë. Në krahun tjetër, te Detroiti spikati Blake Griffini me 20 pikë, ndërkohë që Drummond shënoi 14 pikë, shifra këto që gjithsesi nuk u mjaftuan "pistons"-ave për ta evituar humbjen.

### SHKURT

#### UEFA vendos, katër zëvendësime në ndeshje

UEFA së shpejti do ta miratojë zëvendësimin e katërt në të gjitha ndeshjet e organizuara prej saj. Në takimet e fundit të Komitetit Ekzekutiv, UEFA ka miratuar kryerjen e testeve në fazat e fundit të Kampionatit të Femrave U-19 në vitin 2016 (në Gjermani) dhe 2017 (Gjeorgji), në Evropianin e Femrave 2016 (Sllovakia) dhe 2017 (Irlanda Veriore), si dhe në Kampionatin Evropian U-21, viti 2017 (Polonia) për meshkuj. Pas studimit të kryer në këto turne, UEFA duket e vendosur për ta futur zëvendësimin e katërt në mënyrë përfundimtare, siç diskutohet nga ekzekutivi, i mbledhur të dielën pasdite në Bratislavë.

#### Cutrone: Tash të fokusohemi tek Lazio

Sulmuesi i Milanit, Patrick Cutrone, ka thënë se fitorja 2-0 ndaj Romës erdhi si rezultat i punës së madhe ekipore. Ai është shprehur i lumtur edhe për golin dhe se tani duhet të fokusohet për takimin ndaj Lazios. "Jam shumë i lumtur. Ishte një fitore e rëndësishme, një nga ato që bënë diferencën. Jam edhe më i lumtur që arrita të shënoj gol. Jemi shumë të bashkuar dhe mendoj se fitorja erdhi nga grupi. Trajnerit më të vërtetë i bën për skuadrën dhe të gjithë ne u qëndrojmë urdhrave të tij", ka thënë Cutrone për "Mediaset Premium". Në xhiron tjetër është 'Derby della Madonnina' me Interin që janë të katërtit në tabelë, por sulmuesi italian thotë se është i fokusuar fillimisht për Lazion. "Tani duhet të fokusohemi për të mërkurën ndaj Lazios, pasi dëshirojmë finalen e Kupës së Italisë", ka shtuar Cutrone.

#### Marquezi vazhdon me Hondën në MotoGP

Spanjulli Marc Marquez ka njoftuar se ka vazhduar kontratën me Hondën dhe do të jetë pjesë e saj në MotoGP. Me kontratën e re Marquezi do të qëndrojë në Honda deri në fund të sezonit të vitit 2020. Lajmin e ka bërë me dije spanjulli përmes një postimi në "Twitter". "Jam shumë i lumtur që do të vazhdoj të garoj me Hondën në MotoGP. Jam krenar që jam pjesë e familjes Honda dhe vlerësoj në maksimum mënyrën se si skuadra më jep më të mirën për çdo gjë që kam nevojë. Dy testet e para zyrtare shkuan mirë dhe tani, me rinovimin e kontratës, mund të përqendrohem tërësisht te Botërori", shkruan Marquez. Marc Marquez, kampion bote edhe në kategoritë 125 dhe 250 kubikë, u bë pjesë e elitës së motosportit, MotoGP në vitin 2013, pikërisht me "Repsol Honda", duke fituar menjëherë titullin kampion bote.

#### Bolt: Kam nënshkruar me një klub

Të martën Usain Bolt do ta tregojë klubin me të cilin ka nënshkruar kontratë. Tetë medalje të arta në olimpiada dhe dy rekorde botërore në garat e 100 dhe 200 metrave, por Usain Bolt nuk e ka fshehur asnjëherë dëshirën e tij për t'u shndërruar në një futbollist profesionist. Shumë shpejt ëndrra e vrapuesit nga Xhamajka pritet të bëhet realitet pasi vetëm disa muaj pas tërheqjes nga garat e atletikës, Bolt ka nënshkruar një kontratë si profesionist me një skuadër futbollit. Vetë Bolt e ka dhënë lajmin e bujshëm me një postim në profilin e vet në "Twitter", në të cilin ka bërë me dije se emrin e skuadrës të gjitha fansat e tij do ta mësojnë vetëm ditën e martë. Bolti, që është tifoz i flaktë i Manchester Unitedit, u përfol se ka pasur kontakte me Borussia Dortmundin, madje gjatë muajit mars pritet të bënte një provë me verdhezinjtë. Në muajin e kaluar ai u stërvit me një skuadër që luan në Afrikën e Jugut. Tashmë pritet me kureshtje për t'u mësuar se nga do ta nisë rrugëtimin e tij në futbollin legjenda e atletikës.

*Shijo Pranverën me...*

Jaffa Champion PLUS  
A+C+E Multifrutti  
Taste of World Wide Brand!  
2L

Jaffa Champion

*Produkte Bio natyrale* **MATI**

Djath I Dhisë MATI 300g  
Djath Mati MATI 400g  
Djath Mati MATI 700g  
mati com  
Fajë qumështi i freskët i lopës i pasteurizuar dhe homogjenizuar

Mati -com Sh.P.K. është ndërmarje prodhuese vendore e cila prodhon dhe përpunon qumësht të dhisë dhe lopës

**Fabrika për prodhimin dhe përpunimin e qumështit të Dhisë dhe Lopës**

Email: [mati-com@outlook.com](mailto:mati-com@outlook.com)  
tel: +386 49 288-340  
Kijevë-Malishevë

An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo

N.N.P.Mati Com SHPK



*Gjithmon me merr malli për vonën tëm  
Urimë dita e pavarësisë!*

**RC**  
cola

*Urimë perjetori i 10 Kosovë  
Shpresoj që 10 vjetoria e ardhshme  
fëmijet e mi kanë me qare krenar  
me kësi ba në sot.*


*Njëshita ka shumë punë që me arrit a  
ka duhet por e di që këtu ka njëz që  
shumë dhe kanë besim në ardhmerinë e*

*Sot 10 vjet kjo ditë ka qare anderr për n  
Qe prej asaj dite une besoj që puna m  
gjithmonë kthehet! Urimë Kosova jonë!  
Zemra pushon, vuc këtu!*

**10** mesazhe  
Kosovës

**MADE IN  
KOSOVA**

*Shpresoj ma t'mirën për Kosovën  
e që vitet e ardhshme t'jone ma tsuksesshm  
Gëzuar perjetori i pavarësisë!*



**Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.**